

BESNIK MUSTAFAJ
AUTOPORTRET ME TELESKOP
ROMAN

BOTIMET TOENA

Besnik Mustafaj

AUTOPORTRET
ME
TELESKOP

Roman

Botimi i dytë

BOTIMET TOENA
Tiranë, 2015

Botimi i parë: 2013

Botimi i dytë: 2015

Botuese: Irena Toçi

Redaktore: Beti Njuma

Korrektore letrare: Majlinda Bami

Përkujdesja grafike: Elida Stafa

Kopertina: Lavdie Cenmurati

Në kopertinën e parë: “*Shpirti i aventurës*” nga Magritte

Vizatimet brenda në tekst: © Mustafa Arapi

ISBN 978-9928-4271-6-8

© Autori dhe Botimet Toena

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Nuk lejohet shumëfishimi me çdo mjet apo formë, as me fotokopje, pa lejen me shkrim të autorit.

BOTIMET TOENA

Rr. "M. Gjollësja", K. Postare 1420, Tiranë

Tel.: + 355 4 22 40 116; 22 58 893

Fax: +355 4 22 40 117

E-mail: redaksia@toena.com.al

botimet.toena@gmail.com

[Http://www.toena.com.al](http://www.toena.com.al)

*Autori paralajmëron lexuesit e vet të
çmuar se ky nuk është një roman
autobiografik, edhe pse njëri nga
personazhet quhet Besnik Mustafaj.*

*“Kurrë nuk shkon aq larg,
sa kur nuk di ku po shkon.”*

KRISTOFOR KOLOMBI

*Për t’u treguar i ndershëm,
kisha vetëm një ide fort të
vagullt për subjektin, të cilit
po i qasesha ashtu ethshëm.
Ama zotëroja në mendjen
time një nga përbërësit e
domosdoshëm për çdo vepër
fiksioni: një vend.*

WILLIAM STYRON: -
“Zgjedhja e Sofisë”

Thesari për luftën

*Dikur, atij, njeriut të madh, nuk i mbetej
kurrë një minutë për vete. Shkëlqimplotë
zemërgjerë, ai ia kushtonte gjithë kohën Historisë,
por pa e sjellë nëpër mend shpërfilljen historike
të njerëzve të pashistorisë.*

JACQUES PRÉVERT:
“Popujt e lumtur nuk kanë më histori”
(Gastronomi e kohës)

Në fillim të fillimit, te shqisat e mia mbërriti parfumi i saj, një aromë e përzier frutash, e lehtë, por ngulmuese për të hyrë brenda trupit tim nëpër të gjitha poret e lëkurës, krejt si ato shirat e imta, të cilat, pa farë buje, njomin deri në palcë. Ishte një aromë e matur me mjeshtëri për të mos e mbytur atë avullin e padukshëm që shpërndan rreth vetes femra e që është aq i rëndësishëm për të pohuar praninë e saj femërore. Ajo aromë më erdhi në kohë për të më larguar pak mendjen nga sherri, që sapo kishte bërë aty eprori im me shkrimtarin finlandez Arto Paasilinna e ku unë nuk kisha pranuar të përzihesha, duke i lënë kështu me siguri eprorit tim një përshtypje shumë të hidhur, që ai, ashtu siç e njihja unë, nuk do të mund ta harronte lehtë. Në sytë e tij unë tashmë isha hiç më shumë as më pak veç një dezertor. Por edhe unë për veten time nuk ndjehesha mirë, sado që thellë-thellë vazhdoja të besoja se sherri kishte qënë një gabim nga ana e eprorit tim dhe përfshirja ime në të vetëm do e kishte pezmatuar më tej të keqen. Ky arsyetim i shëndoshë nuk e qetësonte dot një brerje stërgjyshore të ndërgjegjes time : unë e kisha lënë vetëm bashkatdhetarin tim përballë një të huaji. Dhe jo një bashkatdhetar dosido, por udhëheqësin e vendit.

Mora frymë thellë për të mbushur plot mushkëritë me atë aromë të këndshme, por pa asnjë kureshtje për të hetuar nga

vinte. Trurin ma përshkoi tinëzisht një nga ato pyetjet e rrezikshme: me cilën shqisë e ndjen burri më së pari atë avullin e padukshëm, që shpërndan rreth vetes femra? Në këtë rast, ma merr mendja, te mashkulli ashtu si edhe në nxjerrjen e pavullnetshme nga ana e femrës të atij avulli, shfaqej një nga ato instinktët, të cilin njeriu e ka trashëguar nga e kaluara e vet kafshërore. Po me cilën nga shqisat e niste ai instinkt veprimin e vet te mashkulli? Ose më tej: a zgjohej ai instinkt te mashkulli njësoj për të gjitha femrat, që rruga ia sillte pranë apo kishte një mekanizëm misterioz përzgjedhjeje, ku përziheshin edhe elementë të tjerë veç atij avulli? Siç edhe: a vepronte ai avull i trupit femëror me të njëjtin intensitet mbi të gjithë meshkujt e ndodhur njëkohësisht rrotull të njëjtës femër? Po i thosha vetes se e njihja shumë pak trupin e burrit e të gruas, duke sjellë befas dhe pa asnjë qëllim në kujtesë shkrimtarin e mënjanuar prej kaq vitesh nga përditshmëria ime. Po i thosha vetes kështu se, me t'u çliruar, - çlirim e quajta ikjen nga ajo punë dhe, pa ndonjë prapamendim për të ndihmuar veten të çlirohesh, - me t'u çliruar pra, nga puna që bëja, do e mbushja me përparësi këtë boshllëk, që ishte më shumë se një mangësi kulturore në rrethanat e shkrimtarit. Kur dëgjova:

- Ju duhet të më njihni, nuk ka nevojë t'ju jap kartëvizitën.

Kur u ula ta shkruaj këtë histori mbaja mend mirë që zëri më tingëlloi shumë afër veshit të djathtë dhe unë solla kokën trembshëm andej. Ishte një vajzë, e cila mund të merrej edhe si një grua e re. Pothuaj ngjitur me mua (unë isha i ulur), ajo rrinte në këmbë. Më shihte nga lart. Shihte kryesisht tepelekun e kokës time, ku e dija mirë se po rralloheshin flokët. Më përshkoi një rrëqethje acarimi, si ta kisha zënë atë femër duke më përgjuar nga vrima e çelësit. Një përfytyrim kaq bezdisës mund të ma ngjallte vetëm hamendja se ajo ishte ndonjë nga asistentet e zellshme të shkrimtarit finlandez, e cila kishte marrë detyrën të vazhdonte me mua sherrin e plasur pak më parë, në po atë holl hoteli, nga eprori im me punëdhënësin e saj. Pavarësisht asaj brerjes stërgjyshore të ndërgegjes, nuk kisha asnjë gatishmëri për sherr. Në përgjithësi unë nuk kam qenë kurrë i aftë për sherre. Nuk dija të përballesh me të tjerët me ulërima e me sharje. Aq

më pak do të isha i aftë të bëja sherr në Monako dhe nën vështrimet e çmeritura të shumë prej njerëzve me pushtetin më të madh në Europë e në vendet e bregut jugor të Mesdheut. Si të mos mjaftonin të gjitha këto, nuk më përshtatej mua të bëja sherr me një femër.

Dhe jo një femër dosido, një shitëse grindavece fruta-perimesh. Por një femër, sqima e hollë e së cilës dallohej qysh tek aroma që mbante. Thua se po kërkoja një përlijje të re, edhe përtej karakterit tim, për ta shmangur me patjetër sherrin, përsërita me vete se aroma e saj ishte e lehtë, por ngulmuese për të hyrë brenda trupit tim nëpër të gjitha poret e lëkurës, krejt si ato shirat e imta, të cilat, pa farë buje, njomin deri në palcë. Ishte një aromë e përzier frutash e matur me mjeshtëri të lartë për të mos e mbytur atë avullin e padukshëm, që shpërndan rreth vetes femra e që është aq i rëndësishëm për të pohuar praninë e saj femërore në një mjedis të panjohurish. Ama, mua më takonte ta shmangia me patjetër sherrin me atë asistente të ngrehosur të shkrintarit finlandez jo për shkak të aromës së saj turbulluese, por për arsyen themelore se në përgjithësi nuk isha njeri i sherrit dhe në veçanti për këtë rast, një zgjerim i sherrit me asistenten e shkrintarit finlandez vetëm do e shtonte dëmin e bërë pak më parë nga eprori im.

Eprori im duhej ta kishte përmbajtur gjithsesi veten qoftë edhe për shkak të vendit ku gjendeshim dhe të atyre, që do të ishin dëshmitarë pa dashur, sado që zemërimi i tij ishte në një farë mënyre me vend po të mbajmë parasysh natyrën e tij shpërthyesë.

Në të vërtetë, zemërimin të eprorit tim ia kisha vënë unë zjarrin me një mendjelehtësi të pafalshme në rrethanat e njohjes së thellë, që kisha unë me atë burrë prej një jete të tërë, që do të thotë se ia njihja mirë edhe dobësitë e temperamentit. Ne kishim mbërritur në Monako të djeshmen pasdite, pas një pritjeje shumë të gjatë e të mërzitshme në aeroportin Malpensa të Milanos, ku do të merrnim fluturimin për në Nicë. Eprori im e dinte pse

nxitoja unë kur nuk i lashë radhë të shërbehej i pari nga receptionisti i hotelit. Kishte filluar ndërkohë mbledhja përgatitore, ku do të diskutohej teksti i deklaratës së përbashkët, që do të miratohej të nesërmen në samitin e kryetarëve të shteteve apo të qeverive të vendeve anëtare të Bashkimit për Mesdheun. Prania ime në atë mbledhje përgatitore ishte e domosdoshme vetëm për një gjë: ndër të pranishmit vetëm unë do të kujtohesha dhe do të kujdesesha për të shtuar në tekstin e deklaratës një paragraf lidhur me Kosovën. Do të ngjitesha me vrap në dhomë sa për të lënë valixhen, të shpëlaja fytirën e të ndërroja këmbëshën. Në dalje të ashensorit ndesha me tre burra, që i mora pa mëdyshje për njerëz të sigurisë. Hoteli ishte i mbushur me personalitete të larta shtetërore, midis të cilëve kishte edhe nga ata që terrorizmi islamik i mbante posaçërisht në shënjestër, si për shembull, udhëheqësit e shtetit të Izraelit. Të tre burrat u hoqën mënjanë plot mirësjellje për të më liruar kalimin drejt dhomës duke më thënë si me një zë “mirëdita” në anglisht.

- Mirëdita! - ua ktheva unë përsëritet, ndërsa me bisht të syrit, pa ndonjë arsye, vodha dy prej tyre. Ishin dy burra me lëkurë të zeshkët dhe, ashtu të parruar, kishin një hije paksa të egër. Më tërhoqi vëmendjen një metër metalik, që mbante në dorë njëri prej tyre. Kur u solla për të mbyllur derën e dhomës nga brenda, ata po vazhdonin punën e tyre: dy të parruarit, të përkulur mbi dysheme, po matnin gjerësinë e mesores. I treti, në këmbë, shënonte matjet në një bllok të vogël me kapakë të kuq. Për sa më kapi veshi mua, ata nuk thanë gjë tjetër midis tyre veç ca shifrave. Mua vetëm m'u përforcua përshtypja se ata ishin të ngarkuar me sigurinë. Mendja më tha se duhej të isha në kat me ndonjërin nga të fuqishmit, që kishte nevojë për mbrojtje të veçantë, gjë që më la kalimthi një shije të lehtë ankthi. Për herë të parë qysh kur merresha me politikë të madhe, i thashë vetes se, duke u afruar në rrethin e të fuqishmëve të kësaj bote, dashje pa dashje isha afruar edhe ndaj një kërcënimi të pamëshirshëm, i cili qëndronte njësoj varur edhe mbi mua, ani pse as unë dhe as vendi, që unë përfaqësoja, nuk ishte drejtpërdrejt në shënjestër. Nuk besoj se ishte frikë kjo që po ma shtynte mendimin drejt një horizonti të tillë të papëlqyeshëm

ndërsa mbushja duart me ujë të freskët në çezmë për të shpëlarë fytyrën. Ishte pikërisht përfytyrimi i një telashi gjigant, në të cilin do të përzihesha doemos një ditë a një tjetër thjesht pse në një kohë të keqe do të gjendesha në vendin e keq. Vetëdija e pafuqisë për ta shmangur gjithsesi këtë telash më shtrydhi në shpirt ca pika të hidhura ankthi.

Të nesërmen në mëngjes e që përkoi me ditën e samitit, por edhe me ditën e sherrit të eprorit tim me shkrimtarin finlandez, mua më doli gjumi shumë herët. Ndjehesha çuditërisht i ngopur me gjumë dhe i çlodhur mirë. Në mbrëmje, para se të flija, nuk e kisha errësuar dhomën siç bëja më së shpeshti nëpër hotele. Pasqyra e thellë e Mesdheut mbushte suitën time me një dritë mëngjesore të bollshme, të pashtershme, të qelibartë. U përhumba duke vëzhguar muret sikur prisja të bëheshin të tejdukshme nga çasti në çast, aq më ngjante se ato thithnin dritë me babëzi. Për të shmangur ndonjë magji, që mund të pësonte drita tek përshkonte qelqet e dritareve, dola në ballkon. Pasqyra e thellë e detit u shpuzit sakaq e mori zjarr anë më anë. Dielli në lindje ishte ende i kuq. Çova trembshëm duart te sytë, si për t'u mbrojtur nga verbimi dhe u ktheva mbrapsht në dhomë. Më pihej duhan. Por unë nuk e ndez kurrë cigaren e parë të ditës pa ngrënë mëngjes.

Në restorant gjeta vetëm dy klientë dhe ata ishin dy zeshkanët e parruar, që kisha parë pasditen e djeshme të matnin gjerësinë e mesores së katit. Pa asnjë arsye më ra në sy mungesa e të tretit, ai që kishte detyrë të mbante shënim përmasat në bllokun e vogël me kapakë të kuq. Ora nuk kishte shkuar ende shtatë. Veranda e restorantit, ashtu si dhoma ime, shihte nga deti dhe mblidhte një dritë të pamatë për ta derdhur lumë në sallën e madhe të ngrënies. Njëri nga dy zeshkanët e parruar, ai pa mustaqe, ngriti kokën nga pjata dhe më përshëndeti me një buzëqeshje të lehtë. Lëvizën madje edhe buzët e tij dhe unë pata përshtypjen se shqiptoi një "mirëmëngjesi" në shqip. Kishte qenë medoemos një lajthitje e syve të mi, që nuk po mësoheshin ende me gjithë atë ndriçim mëngjesor të Mesdheut. Unë i kisha përcaktuar ata si njerëz të sigurisë dhe, si të tillë, nuk mund të prisja nga ndonjëri prej tyre të dinte shqip. Ia ktheva edhe unë

buzëqeshjen, shqiptova përshëndetjen time me majat e buzëve në anglisht siç isha i sigurt se flisnin dhe u afrova te banaku, ku do të zgjidhja hajet. Nuk kisha uri. Darka, shtruar në pallatin princëror nga princi të mbrëmshmen në cilësinë e mikpritësit për të gjitha delegacionet, kishte qenë vërtet princërore. Por unë isha i vendosur të përtypja diçka, të pija edhe një kafe për ta bërë të plotë zakonin para se të ndizja cigaren e parë e që ishte gjithmonë edhe cigarja më e dëshiruar e ditës.

Po sillesha ngadalë rrotull banakut të mbushur me haje nga më të ndryshmet, të ngrohta e të ftohta, të ëmbla e të kripura, të ziera e të pjekura, apo edhe fare pa zier e pa pjekur, ardhur nga deti e nga toka, nga mali e nga fusha, kuzhinë franceze, italiane, libaneze, meksikane, kineze, me erëza nga më të rrallat, apo edhe pa erëza fare. Në rrethana të tilla nuk e dija kurrë çfarë kërkoja. Më udhëhiqte thjesht instinkti i oreksit. E shkurtova këtë shëtitje të mrekullueshme vetëm se po ndjeja mbi vete pak si tepër ngulmues vështrimin e zeshkanit që më kishte përshëndetur. Mora një komposto pjeshke dhe zgjodha një tryezë në anën e kundërt të qoshes, ku hanin dy zeshkanët e parruar. Ata kishin zënë vend në fund të sallës. Pas supeve të tyre ishte muri. Megjithatë, salla hapej në një mënyrë të tillë, që syri e rrokte të tërë hapësirën, kudo që vendoseshe. Tryeza ime ishte krejt pranë hyrjes. Rehat do të isha po të ulesha me shpinë nga të dy zeshkanët e sigurisë. Por u kujtova sakaq se do të bezdiseshja nga vështrimet dhe përshëndetjet rutinore të kolegëve, të cilët nuk do të vononin të zbrisnin për të ngrënë. Vendosa të ulesha me shpinë nga hyrja, sado që e dija, se do të isha gjithë kohën nën vëzhgimin zhbirues të zeshkanit pa mustaqe.

Çfarë hetonte ai në mua? Kjo pyetje ishte ndoshta gabimi im i atij mëngjesi: jashtë vullnetit tim nisi të zgjohet brenda meje një kureshtje. Në sytë e zinj të atij burri, i cili nuk dukej të ishte shumë më i moshuar se unë, kishte një këmbëngulje të papërcaktueshme. Në vështrimin, që ai hidhte mbi mua, mungonin ato shkëndijimet e posaçme të njeriut të sigurisë, i cili, në një mënyrë a në një tjetër, është gjithë kohën si mbi thumba. Nuk do të dalloja në atë vështrim as ndonjë dyshim rreth meje dhe as atë qetësinë, që një nëpunës i tillë ka për detyrë

t'i përcjellë të mbrojturit të vet. Ishte një vështrim pa asnjë nga shenjat që do të më ndihmonin për të kuptuar se isha i dyshuari i tij apo qoftë i mbrojturi i tij. Nga ana tjetër nuk ishte as vështrimi i ndrojtur i një adhuresi, që do të kishte dashur të më afrohej për të marrë një autograf a për të bërë një fotografi, siç nuk ishte as vështrimi përgjues i ndokujt, që kishte një hesap të fshehtë për të larë me mua. Nuk dija si të sillesha ndaj atij vështrimi, i cili zuri të më mbante lidhur pas vetes me misterin e tij. Kisha mbaruar së ngrëni, por nuk më jepej të dilja në verandë, ku do mund ta pija cigaren e parë, e cila do të duhej të ishte siç kishte qenë gjithmonë: cigarja më e shijshme e ditës për mua.

Në atë lloj hutimi më tërhoqi, megjithatë, vëmendjen diçka: të dy zeshkanët e parruar kishin një oreks të çartur. Ata i mbushnin bulçitë si njerëz thellësisht të uritur dhe përtypeshin me nxitim, në heshtje të plotë, si me një frikë se nga çasti në çast do të shfaqej dikush për t'i përzënë pa u lënë kohë të ngopen. E mbaronin shpejt e shpejt pjatën dhe, në një garë të vërtetë me njëri-tjetrin, ktheheshin te banaku i hajeve, ku nuk përbuznin asgjë: vezë të ziera, omëletë, vezë të skuqura sy, shoqëruar me copëra të mëdha djathërash nga të gjitha llojet dhe lëng molle, portokall të shtrydhur, qitro të shtrydhur, përzierje frutash (lëng), sallatë frutash, proshutë, pastërma, peshk të tymosur, një varg i pafundmë sallamërash, salsiçe derri, salsiçe pule, salsiçe viçi, suxhuk, zarzavate të ziera, të skuqura, apo edhe pa zier e as skuqur, - në shijen e tyre të parë, siç ua ka dhënë natyra, - me patate të skuqura për t'i shoqëruar, me patate të ziera, me salcë domate, me salcë kërpudhash, me mustardë apo edhe pa asgjë fare. Të dy zeshkanët e parruar ndiqnin njëri-tjetrin te banaku i hajeve dhe mbushnin pjatat për t'i kullufitur, - siç po vëreja, - sakaq. Njëri nuk e kishte oreksin më të përmbajtur se tjetri.

Ngulitja e pavetëdijshme pas oreksit të shpërmasur të të dy zeshkanëve të parruar, për të cilët dyshoja tashmë të ishin nëpunës të sigurisë, por pa patur në kokë ndonjë hamendje të re rreth arsyes pse gjendeshin ata në hotelin, ku ishin strehuar

pothuaj të gjithë njerëzit më të pushtetshëm të Europës e të Afrikës së Veriut, pra, ngulitja e pavetëdijshme pas oreksit të tyre të shpërmatur m'u ndërpre "shtrak", siç këputet shiriti i një filmi, pikërisht kur të dy zeshkanët e parruar po përfundonin me sallamërat e salsiçet. Gjatë takimit me Myzafer Zhivinin, pak javë para Krishtlindjeve të kaluara, në qytetin tonë të lindjes, ai më kishte treguar se Selami Beshiri i kishte lënë pa gojë autoritetet belge të emigracionit kur u kishte shpjeguar - me atë durimin e vet të pashembullt - pse kishte vendosur të largohej nga qyteti i vet i vogël në veri të Shqipërisë për të jetuar në zemër të Europës. Me një seriozitet që vetëm Selami Beshiri mund ta mbante në rrethana të tilla, ai u kishte pohuar përgjegjësve të Zyrës Për Të Huajt se kishte një ëndërr të porealizuar qysh nga fëmijëria e hershme: të shuante nepsin për sallame e për salsiçe. Nuk është e vështirë të përfytyrohet shtangia e njerëzve të asaj Zyre. Të mësuar të dëgjojnë gjithfarë të vërtetash nga më të hidhurat, siç edhe gënjeshtro nga më të stërholluarat nga azilkërkuesit e ardhur nga të katër anët e botës, nëpunësit e Zyrës Për Të Huajt doemos që nuk u kanë besuar veshëve dhe i kanë kërkuar Selami Beshirit të përsëriste fjalën e vet të mbrojtjes. Njëkohësisht ata i kanë kërkuar përkthyesit të ishte tejet i vëmendshëm për të pikasur mirë në rast se azilkërkuesi fliste me nënkuptime.

Selami Beshiri, pa asnjë shenjë turbullimi dhe me një pamje plotësisht mirëkuptuese për habinë, që kishte ngrirë si krem i papërshtatshëm mbi fytyrat e atyre tre burrave me uniformë, të cilët do të vendosnin për të ardhmen e tij "belge", nisi nga e para, por duke shtuar hollësi në tregim, gjë që e kishte trashur habinë në fytyrat e tre zyrtarëve. Ata do të kishin qenë në të drejtën e tyre të dyshonin se po tallej me ta ky shqiptar krejt ndryshe nga mijëra shqiptarët e Shqipërisë, të Kosovës, të Maqedonisë dhe të Malit të Zi, të paraqitur para tyre gjatë afro njëzet vjetëve të fundit për të kërkuar azil politik. Kishte diçka në sytë e Selami Beshirit dhe në seriozitetin, me të cilin e përshkruante ai hallin e vet, - një pafajësi dhe një brengë - që i pengonte ata nëpunës të regjuri me pehliuanllëqet e azilkërkuesve, të besonin se ai po tallej me ta.

Selami Beshiri nuk po tallej. Ai po u tregonte se diku nga mosha dhjetë vjeç kishte parë, fare rastësisht, në televizionin

jugosllav një reklamë për sallamrat belge dhe qysh atëherë jetonte me ëndrrën e fshehtë për të ngrënë nga ato sallamra të paktën deri sa të ndjente gropësimat e ngopjes t'i ngjiteshin nga fundi i barkut nëpër gurmaz si hardhuca gazmore. Kur festoi 45 vjetorin e lindjes, ishte bindur përfundimisht se vendi i tij, Shqipëria e tij e dashur, në liri tashmë, po zhvillohej aq ngadalë, sa atij nuk do i mjaftonte jeta për ta realizuar këtë ëndërr të vjetër duke qëndruar në qytetin e vet të lindjes. Shkurt: atë e kishte shtyrë drejt mërgimit dhe posaçërisht drejt Brukselit dëshpërimi i ëndrrës së porealizuar. Nuk kishte si shprehej më qartë e më thjeshtë një brengë e tillë dhe prapë të mbetej thelbësisht e pakuptueshme dhe po aq turbulluese, njësoj për të tre zyrtarët e zellshëm. Përvojat e ndryshme nuk e ndihmonin njërin më shumë se tjetrin për të arritur në një përfundim të qartë.

Zyra Për Të Huajt kishte për detyrë të regjistronte me saktësi të plotë motivimin e kërkesës për azil dhe të verifikonte imtësisht nëse Belgjika ishte ligjërisht kompetente për ta marrë në shqyrtim këtë kërkesë. Të tre përfaqësuesit e kësaj Zyre, të cilëve u kishte rënë shorti ta dëgjonin parashtrimin e Selami Beshirit, ishin sigurisht të detyruar ta regjistronin fjalë për fjalë kërkesën e tij për azil. Por ishte në detyrimin e tyre profesional gjithashtu që të verifikonin me kujdes përshtatshmërinë e kësaj kërkesë me kuadrin ligjor në fuqi në Mbretërinë e Belgjikës lidhur me pranimin ose rrëzimin e një kërkesë për azil. Pikërisht në këtë hallkë të tre përfaqësuesit e sprovuar të shtetit belg kishin ngecur. Legjislacioni, mbi të cilin ata mbështeteshin në punën e tyre prej vitesh e vitesh, nuk kishte parashikuar një përgjigje të mirë as të keqe për një shembull të ngjashëm me atë të Selami Beshirit. Ata i kishin dhënë dum ta përcillnin rastin, natyrisht me një përshkrim të hollësishëm, në instancën eprore, e që ishte Komisariati i Përgjithshëm për Refugjatët dhe të Paatdhetë, ku kërkesa e Selami Beshirit u shoshit nga të gjitha anët, por ku përsëri nuk u mor dot një vendim. Komisariati i Përgjithshëm për Refugjatët dhe të Paatdhetë, pasi qortoi rëndë Zyrën Për Të Huajt për shmangie nga përgjegjësia e marrjes së vendimit, hartoi një letër përcjellëse dhe e nisi dosjen, brenda afateve ligjore, në Këshillin për Mosmarrëveshjet me të Huajt. Në letrën

përcjellëse, në një përpjekje për t'u dukur sadopak serioz para instancës eprore, ky Komisariat shtronte pyetjen nëse rasti në fjalë paralajmëronte afrimin e një faze të re për sa i përket cilësisë së emigracionit, kur njerëzit do t'i jepnin të drejtë vetes të braktisnin vendin e tyre të origjinës jo më vetëm për shkak të represionit të egër politik, as për shkak të varfërisë së skajshme, por edhe për të mos ikur nga kjo botë pa përmbushur ëndrrat e çuditshme të fëmijërisë. Ky Komisariat e njoftonte Këshillin për Mosmarrëveshje me të Huajt se kishte kryer hetimin e vet të tërthortë rreth personalitetit të Selami Beshirit dhe kishte arritur në bindjen se ai nuk ishte as i rrjedhur, as gënjeshtar e as provokator. Nga të dhënat e mbledhura mbi jetën e tij në Shqipëri nën diktaturën staliniste të Enver Hoxhës, nuk binte në sy që ai dhe familja e tij të kishin vuajtur politikisht e as ekonomikisht më shumë se mesatarja e popullsisë, siç nuk dilte të pah që Selami Beshiri, gjatë adoleshencës dhe rinisë së vet të parë të kishte qenë kundërshtar i regjimit e as bashkëpunëtor i Sigurimit. Shkurt fjala, ishte një njeri pa biografi, siç thuhej për një rast të tillë në gjuhën e këtij Komisariati.

Kjo letër e Komisariatit të Përgjithshëm për Refugjatët dhe të Paatdhetë bashkë me dosjen e përgatitur nga Zyra Për Të Huajt krijoi në Këshillin për Mosmarrëveshje me të Huajt një pështjellim të paparë. Ky Këshill ishte ngritur për të zgjidhur mosmarrëveshjet e lindura në Zyrën Për të Huajt apo në Komisariatit të Përgjithshëm për Refugjatët dhe të Paatdhetë dhe vihej në veprim pas ankimimit të të huajit azilkërkues apo atij të paatdhe. Formalisht në këtë rast nuk kishte mosmarrëveshje. Shqiptari Selami Beshiri nuk kishte paraqitur ndonjë ankesë për arsyen e pastër se nuk mund të kishte ankesë për sa kohë nuk kishte ende një vendim lidhur me kërkesën e tij. Procedura e pengonte Këshillin për Mosmarrëveshje me të Huajt të shqyrtonte një dosje, ndaj të cilës nuk kishte ankimim. Përzjerja në këtë çështje, në gjendjen që ajo kishte mbërritur atje lart, do të thoshte për këtë Këshill që ai të merrte kompetencat e instancës së parë, - Zyrës Për Të Huajt, - gjë që ia ndalonte rreptësisht ligji. Anëtarët e Këshillit në fjalë falenderuan procedurën, që po i çlironte nga një siklet i

pazakonshëm dhe vendosën ta hiqnin shpejt e shpejt duarsh këtë dosje duke e dorëzuar në Këshillin e Shtetit. Më lart nuk kishte. Këshilli i Shtetit ishte i detyruar të dilte me një përfundim, i cili do të ishte një përgjigje e formës së prerë për azilkërkuesin, por mund të ishte edhe një urdhër për rifillimin kalvarit të azilkërkuesit nga e para, domethënë në Zyrën Për Të Huajt. Gjithçka ishte në kompetencën e Këshillit të Shtetit.

Selami Beshiri vazhdonte ndërkohë krejt i qetë jetën e vet në Qendrën e Pritjes së Azilkërkuesve. Ai kishte vënë re, megjithatë, një ndryshim pas paraqitjes në Zyrën Për Të Huajt: në të tri vaktet e ngrënies kuzhina i shërbente posaçërisht atij dhe askujt tjetër nga të strehuarit në Qendër, një pjatë më vete me lloje të ndryshme sallamërash dhe salsiçesh. Ai e pranonte me një buzëqeshje kënaqësie, por pa i shtruar vetes dhe as kujdestarëve të Qendrës pyetjen përse ky privilegj vetëm për atë. Ai nuk e merrte me mend dhe madje as nuk e lodhte kokën për ta marrë me mend se çfarë trazimi kishte shkaktuar në zyrat e larta të shtetit.

Në Këshillin e Shtetit dosja e Selami Beshirit pati fatin të binte në duart e një këshilltari veçanërisht të zellshëm dhe me imagjinatë shumë të pasur. Pasi e lexoi me kujdes, Këshilltari në fjalë nënvizoi një fakt, mbi të cilin gjykoi se duhej të përqendrohej për raportin e vet: lindur e rritur në një vend stalinist, një vend hermetikisht i mbyllur ndaj lëvizjes së lirë të njerëzve, të mallrave, të kulturave e të informacionit me pjesën tjetër të botës, përfshirë këtu edhe vendet e tjera komuniste, midis të cilave edhe fqinji më i afërt i Shqipërisë, Jugosllavia e Titos, azilkërkuesi Selami Beshiri sillte një shembull plot domethënie për epërsinë e papërballueshme të sistemit të ekonomisë së tregut të lirë, një epërsi kjo jo vetëm ekonomike, mbi modelin e zhvillimit sovjetik, siç edhe ishte dëshmuar tashmë nga Historia. Epërsia kishte qenë thellësisht kulturore dhe psikologjike mbi vetë individin. Projektin e njeriut të ri komunist e kishte shpërbërë qysh në zanafillë jo truri, por stomaku i njeriut - subjekti i këtij projekti. Gjithë sistemi kompleks dhe i kudogjendshëm e i kurdohershëm i propagandës dhe edukimit të regjimit revolucionar nuk kishte arritur t'i rrënjoste të riut Selami Beshiri një ëndërr që t'i mbijetonte kohës, gjë që e kishte arritur një spot

i vetëm publicitar për sallamërat belge. Këshilltari në Këshillin e Shtetit e zhvillonte gjerësisht analizën e vet, por ai e mundi tundimin për t'u takuar me Selami Beshirin edhe pse një gjë të tillë ia lejonte ligji. Këshilltari ndjeu frikën e fshehtë të ndonjë zhgënjimi nga njohja e drejtpërdrejt me protagonistin e historisë, me pasojë ftohjen e entuziazmit dhe kufizimin e imagjinatës gjatë shkrimit të raportit e sidomos më vonë, kur do i duhej ta mbronte këtë raport para kolegëve të vet, para shtypit e ndoshta edhe para parlamentit apo në audiencë me Mbretin. Ai kishte tashmë një prapamendim për ta shndërruar këtë histori në një ngjarje publike si dhe të shkruante një libër, që do të ishte aventura e tij e re: një roman. Sidoqoftë, me rëndësi për fatin e Selami Beshirit mbetet propozimi, me të cilin këshilltari e mbyllte raportin. Me një gjuhë të zjarrtë, të denjë për rastin, ai shprehte bindjen e vet se Këshilli i Shtetit duhej t'i jepte Selami Beshirit lejë qëndrimi në Mbretërinë e Belgjikës, duke hapur kështu rrugën që azilkërkuesi të merrte në vazhdim, pa rrjedhur shumë kohë, edhe shtetësinë belge, gjithnjë në përputhje me procedurat ligjore. Në bindjen e këshilltarit, në këtë rast Këshilli i Shtetit do i bënte një nderim shembullor vetë vlerës së patjetërsueshme të lirisë, vlerë kjo në themelet, mbi të cilat ishte ngritur dhe mbështetej shteti dhe shoqëria belge.

I përhumur në këtë histori, të cilën Myzafer Zhivini ma kishte treguar tek pinim kafe në qytetin tonë të lindjes diku gjashtë muaj më parë, nuk e kisha vënë re fare zeshkanin e parruar, atë pa mustaqe, tek afrohej te tryeza ime. Mendimi i parë që më kaloi nëpër kokë, ishte: (të dy zeshkanët e parruar) paskan mbaruar së ngrëni. Të jenë ngopur, vallë? Dhe, instinktivisht, hodha vështrimin nga banaku i hajeve, a thua se doja të verifikoja nëse kishte mbetur gjë për klientët e tjerë të hotelit, që kishin filluar të shtoheshin në sallën e restorantit. Zeshkani i parruar dhe pa mustaqe po më fliste shqip, por unë isha aq i hutuar, sa iu përgjigja në anglisht. Ai më buzëqeshi butësisht dhe më shpjegoi se nuk dinte anglisht. Ai fliste vetëm gjermanisht.

- ... dhe, natyrisht, shqip, - shtoi ai dhe buzëqeshja e butë, që ia kishte mbushur krejt fytyrën, i jepte një hije të lehtë prej burri që përpiket të shfaqësohet për një gabim të dikujt tjetër.

U ndjeva unë në gabim për veten time dhe brofa në këmbë. Nuk e kisha përshëndetur ende, ndërkohë që ai po më pyeste nëse e kisha lënë duhanin. Zeshkani i parruar, i cili, për më tepër, më fliste pastërtisht shqip, nuk mund të kishte gjetur pyetje më të paparashikuar për mua. Nuk dija si ta merrja një pyetje të tillë, e cila, zakonisht nuk i takon një të panjohuri. Isha në këmbë, përballë tij. Hundët tona nuk ishin më shumë se dy pëllëmbë larg njëra-tjetrës. Ishte përsëri kujtimi i Selami Beshirit që më nxiti ta merrja me mend largësinë midis nesh nisur nga maja e hundës time deri te maja e hundës së tij. Selami Beshiri thoshte dikur se hunda e burrit duhet të jetë aq e dalë përpara sa, po t'i mbyllet këtij burri dera në surrat, ajo duhet t'i zërë hundën dhe asnjë pjesë tjetër të trupit. Zeshkani e pikasi, me sa duket, pakënaqësinë time për shkak të pyetjes së tij lidhur me duhanin dhe nxitoi të më kujtonte se më parë unë edhe në televizion dilja me cigare të ndezur. Qysh se isha bërë ministër e kisha hequr cigaren në shfaqjet publike. U mata t'i kthehem se tashmë edhe Shqipëria kishte një ligj që e ndalonte duhanin në hapësirat publike, por ai nuk më la kohë.

- Kancelari Helmut Schmidt, edhe pse i ka kaluar të nëntëdhjetat dhe është ai që është në historinë e shtetit gjerman e të vetë Europës, nuk i dridhet syri ta ndezë duhanin para kamerave edhe sot e kësaj dite, - më tha si për të më hequr çdo dyshim se po më qortonte.

Unë vetëm i buzëqesha, në përpjekje për ta fshehur acarimin pse ai ndjehej para meje më i çliruar se unë para tij.

- Nuk e kam lënë duhanin, - i thashë. - Por nuk pi atje ku ligji e ndalon. Unë nuk do të kem kurrë aq të drejtë sa ç'ka kancelari Helmut Schmidt për ta përjashtuar veten nga zbatimi i një ligji, me të cilin nuk më pëlqen të pajtohem. - U drejtova nga veranda, i bindur se ai do të më ndiqte. Dhe ai vërtet më ndoqi. Unë arrita ndërkohë t'i bëj vetes një pyetje të nevojshme: përse më duhej njohja me këtë njeri? Funkzioni nuk ma kërkonte, por as edhe ndonjë kureshtje të madhe nuk kisha më. Atë habitjen, që më kishte shkaktuar oreksi i tij i çartur, e kisha kapërcyer, siç e kisha zbuluar tashmë edhe misterin e vështrimit të tij mbi mua: ai ishte shqiptar. Përmendja e duhanit tim në

publik ishte sa për të më dhënë të kuptoj se më njihje prej kohësh. Kisha të paktën shtatë vjet pa pirë duhan atje ku ndalohej. Zgjodha në verandë hijen që më përshtatej dhe nxora sakaq qesen e duhanit për të dredhur cigaren krejt si të isha vetëm. Zeshkani i parruar u soll të më dilte përballë. Kishte në dorë paketën e vet të cigareve.

- Nuk e paskeni ndërruar zakonin, - më tha, duke treguar me sy nga gishtat e mi, që rrotulloheshin për të dredhur cigaren. Nuk u orvat të më zgjaste një nga cigaret e veta të gatshme, si njeri që e dinte se nuk do e pranoja.

Unë mblodha supet me një përshtypje të largët bezdie. Ai po i jepte vetes liri me tepri duke më vënë në dukje hollësira nga veset e mia. Ra një heshtje e shkurtër. Të dy thithnim fort cigaret tona. Ishte një qetësi aq e thellë, sa më dukej sikur dëgjoja zhurmën e tymit të duhanit tek përcillej poshtë nëpër fytin tim. Zeshkani i parruar më tha më në fund emrin e vet: Gjergj Shkodra. Dhe shtoi:

- Në letrën e njoftimit kam një emër tjetër. Ky është emri i personazhit që më duhet të mishëroj këto ditë. - Dhe në fytyrën e tij u shpalos ajo buzëqeshja e butë bashkë me atë hijen prej burri në siklet për t'u shfajësuar për një gabim të dikujt tjetër.

Unë u luhata nëse duhej ta pyesja çfarë pune bënte për të qenë i detyruar të fshehë emrin, apo të largohesha sa nuk kisha rënë ende shumë në sy me të. Zeshkani i parruar nuk më la kohë ta zgjidh mëdyshjen time. Ai vazhdoi:

- Këtë javë punoj për një shkrimtar finlandez. Arto Paasilinna quhet. E mban veten për shkrimtar të madh. Keni dëgjuar për të?

Unë e sigurova se ishte shkrimtari bashkëkohor finlandez më i njohur në botë. Të paktën me aq sa dija unë. Kisha madje në shtëpi një nga romanet e tij të përkthyer në italisht, që nuk e mbaja mend kush ma kishte dhuruar. Nuk e kisha lexuar ende. Do e lexoja patjetër tani që kisha kureshtjen e re. Nisa të dredh një cigare të re për t'i treguar zeshkanit të parruar, të cilin në vazhdim edhe unë do e thërras Gjergj Shkodra, se dëshiroja ta zgjasja bisedën me të. Kisha edhe afro një orë kohë të lirë. Nuk e merrja dot me mend se çfarë pune mund të kryente për një shkrimtar Gjergj Shkodra bashkë me zeshkanin tjetër, atë me

mustaqe. Në mos truprojë. Po ç'nevojë kishte një shkrimtar si Paasilinna për një truprojë? Aq më tepër dy? Dhe që të dy të papërshtatshëm, sipas gjykimit tim, për t'u besuar mbrojtjen e jetës. Gjergj Shkodra dallohej që i kishte kapërcyer të pesëdhjetat, ishte pak më i gjatë se unë, por i dobët dhe pa muskuj, si njeri që e ka lënë me kohë veten pas dore. Zeshkani tjetër, ai me mustaqe, i cili në vazhdim do të përmendet si "përkthyesi", ngjante pak më i ri se Gjergj Shkodra, ishte pak më i gjatë dhe me trup pak më të lidhur. Por as ai nuk shëmbëllente gjëkund me trupin e një burri të stërvitur për ndeshje të ashpra trupore. Gjithsesi, unë nuk isha aty për të bërë vlerësimin e aftësive të të punësuarve të shkrimtarit finlandez, siç edhe nuk më ndihmoi aspak për të përfytyruar diçka tjetër ajo që kisha parë të djeshmen: Gjergj Shkodra me përkthyesin tek matnin gjerësinë e mesores së katit, ku unë kisha dhomën dhe një i tretë, i cili shënonte masat në një bllok të vogël me kapakë të kuq. Fakti se Gjergj Shkodra dhe përkthyesi punonin për një shkrimtar të shquar nuk ma fshiu krejt një farë mëdyshjeje nëse duhej të bija kaq shumë në sy me këtë burrë, i cili ishte paraqitur para meje me një nofkë? Ishte një refleks vetëmbrojtës, zhvilluar tek unë me kohë duke u ngjitur lart në karrierën politike.

I shtyrë ndoshta nga një dëshirë e fshehtë për ta mësuar sa më vonë të vërtetën e punës që Gjergj Shkodra kryente për shkrimtarin finlandez, apo ndoshta i shtyrë nga një dëshirë e ligë për ta poshtëruar pak këtë bashkatdhetar të paparashikuar në agjendën time, i kujtova sa përshtypje të madhe më kishte bërë oreksi i babëzitur i tij dhe i kolegut të vet.

- Ku e çoni gjithë atë ushqim? - iu drejtova duke matur me sy nga koka te këmbët trupin e tij të dobët.

Gjergj Shkodra nuk shfaqti asnjë shenjë lëndimi në sedër dhe as nuk më qortoi për mungesë takti. Ai më tha se bashkë me kolegun e vet hanin vetëm një herë në ditë, kafjallin, që ishte i përfshirë në çmimin e dhomës së hotelit e që paguhej nga punëdhënësi. Drekën dhe darkën ata e kishin në shpenzimet e veta. E tillë ishte kontrata, që do të thotë se ata nuk hanin

zakonisht drekë e as darkë. Por ai ishte i kënaqur me aq. Puna ishte e lehtë dhe nuk ndjehej fort uria. Ama, pinin edhe dy kafe gjatë ditës. Zakonisht i qeraste punëdhënësi, për të cilin Gjergj Shkodra nuk kishte vërejtje.

- Ne jemi emigrantë, - tha. - Na duhet të kursejmë para duke ia hequr gojës. Nuk kemi marrë rrugët e botës për të bërë qejf në hotele si ky. Mirë do të ishte, por kjo është jeta: kur u nda, kaq na ra.

Ai po më thoshte se kaq i kishte dhënë fati dhe nuk dukej as i dëshpëruar për jetën që bënte e as i zemëruar me fatin. Ishte radha ime të ndjehesha fajtor pse isha sjellë keq me të. Nxora një "më falni" me majat e buzëve, të cilës Gjergj Shkodra nuk i kushtoi asnjë vëmendje. Ai po më fliste ndërkohë për veten. Kishte kryer studimet ushtarake në Tiranë për xhenio dhe kishte punuar më shumë se dhjetë vjet në ushtri si inxhinier në sistemin e fortifikimit. Ishte marrë kryesisht me bunkerët dhe tunelet për strehimin e artilerisë së rëndë rrotull kryeqytetit. Me ardhjen e demokracisë, kur edhe ushtria nuk mund të ishte më ajo që kishte qenë, nuk do të kishte më as punë për të. Kishte marrë rrugën e mërgimit bashkë me familjen, si shumë të tjerë dhe ishte vendosur në Gjermani, në rrethinat e Munihut, pse atje kishte shkuar para tij një nga shokët e tij më të ngushtë, i cili do ta ndihmonte edhe për të kapërcyer vështirësitë e fillimit të jetës së re. Punonte në ndërtim, por jo si inxhinier. Kishte mësuar zanatet e muratorit, të bojxhiut, të hidraulikut, të elektrikistit. Kjo kontratë me shkrimtarin finlandez ishte për të rasti i parë për të kujtuar profesionin e dikurshëm, sado që në rrethanat e një roli, diçka e ngjashme me teatrin, por pa spektatorë. Më saktë, me vetëm një spektator, që ishte njëherësh edhe regjisori i këtij teatri.

Arto Paasilinna, si gjithë shkrimtarët e mëdhenj, donte ta prekte realitetin, që do të përshkruante në romanin e ardhshëm. Ai nuk i besonte me tepri imagjinatës së vet, edhe pse subjektet e librave të tij zanafillën e kishin pikërisht në imagjinatë. Autori sajonte pastaj një lloj maketi-realitet në përmasat e atij të imagjinuar, i cili, në përputhje me metodologjinë origjinale të shkrimtarit, duhej të shërbente për të verifikuar sa e besueshme do të ishte nesër për lexuesin historia që do të tregohej. Në

romanin e tij të ardhshëm, ai do të hidhte një vështrim nga Shqipëria. Personazhi do të quhej Gjergj Shkodra. Gjergji, në kujtim të heroit kombëtar të shqiptarëve Gjergj Kastrioti-Skënderbeu dhe Shkodra, qyteti më i rëndësishëm i Shqipërisë së Veriut dhe njëra nga qendrat më rrezatuese të botës shqiptare dhe të krejt Ballkanit për tregtinë dhe kulturën të paktën qysh nga mesjeta e vonë. Një kombinim të tillë kaq domethënës shkrimtari e kishte sajuar pas hulumtimeve në një guidë politiko-turistike për Shqipërinë, hartuar nga maoistët e Helsinkit dhe botuar në fillim të viteve '70 të shekullit të kaluar.

Gjergj Shkodra, zeshkani i parruar, me të cilin po pija unë duhan në verandën e njërit nga hotelet më luksoze të Monakos, nuk ishte në gjendje të më thoshte sa vend do të zinte personazhi me emrin e tij në romanin e ardhshëm të shkrimtarit finlandez. Ndoshta, madje, as vetë shkrimtari nuk e dinte ende mirë. Çdo mbrëmje, para se të ndaheshin, ai u jepte dy të punësuarve të vet, shtypur në një fletë A4, linjat e përgjithshme të episodit, mbi të cilin do të punonin të nesërmen, që do të thotë se ai vetë si autor ishte ende në fazën e ngjizjes së subjektit. Gjergj Shkodra dhe kolegu i tij po ashtu zeshkan dhe i parruar, por edhe me mustaqe, një serbo-boshnjak ky me emrin Girill Jugrazar e që në roman do të shërbente si përkthyes midis shqiptarit dhe finlandezëve, nuk duhej të flinin pa përvetësuar tekstin. Ata strehoheshin në një dhomë të përbashkët, sigurisht për të shpenzuar më pak, por edhe për të ndihmuar njëri-tjetrin në këto përgatitje për punën e nesërme.

Deri ditën kur u takuan bashkë, pra, gjatë afro një jave punë, ish-inxhinieri i xhenios, në Ushtrinë Popullore, kishte mësuar për veten e vet të nesërme, kur do të ishte i përjetësuar në një roman finlandez, se mishëronte një arkitekt shqiptar, i cili, në pjesën e parë të jetës së vet profesionale, e që përkonte me dekadën e fundit të regjimit komunist, ishte marrë me projektimin dhe ndërtimin e bunkerëve. Kjo ishte dhe arsyeja pse ishte zgjedhur pikërisht ky zeshkan për të luajtur përpara shkrimtarit. Ai do e kishte më të lehtë rolin dhe do të shfaqej i

natyrshëm, sepse do të luante doemos vetveten. Me të vërtetë që ai nuk kishte përvojë tjetër profesionale si inxhinier në vendin e vet veç asaj në ndërtimin e bunkerëve. Shkrimtari ishte i bindur se ky zeshkan i parruar do të nxirrte nga fundi i kujtesës së vet të gjitha detajet që i nevojiteshin atij si autor për ta veshur Gjergj Shkodrën, gjatë shkrimit, me jetë të besueshme prej inxhinieri shqiptar, i cili mbart në veten e tij simbolikën e vetë Historisë së re të Shqipërisë, një Histori e ndarë dhunshëm në dy gjysma pa vazhdimësi në njëra tjetrën. Shkrimtari në fjalë do e hidhte në koshin e plehrave një vepër, ku personazhet ngjajnë si me kukullat e stisura në punishte. Zeshkani i përzgjedhur besonte se nuk do e zhgënjente deri në fund punëdhënësin e vet të pazakonshëm. Nga ana tjetër, ai po argëtohej mirë edhe për vete, duke e përjetuar atë, që i kërkohej të kryente, si një lojë të vërtetë teatri.

Gjergj Shkodra, ky arkitekt i kalitur në konceptim dhe ndërtim bunkerësh, me rënien e regjimit stalinist, të cilit i kishte shërbyer me të gjithë përkushtimin e vet, kupton shpejt se epoka e lavdisë për të mori fund njëherë e përgjithmonë. Po fillonte epoka e pasurimit dhe atij i takonte më shumë se të tjerëve të tregonte tashmë sa i zoti ishte të bënte para. Me intuitën e ushtarakut që përzgjedh betejën e vet për të ngadhënjyer, ai u kthye pa humbur kohë drejt turizmit. Në morinë e dokumentarëve dhe të reportazheve, që përmbytën kanalet televizive anembanë botës në ata muaj të parë të hapjes së vendit, Gjergj Shkodra vuri re se vihej vazhdimisht theksi mbi të ardhmen e turizmit si një pasuri e madhe kombëtare, me shfrytëzimin e mirë të së cilës shqiptarët mund të dilnin shpejt nga varfëria. Por mungonte një strategji zhvillimi në këtë fushë, siç mungonte tërësisht edhe infrastruktura. Gjergj Shkodra mbajti mend që në këto dokumentare e reportazhe nuk përmendej ndonjëherë se mungonin paratë. Dhe nuhatja e tij u vërtetua: Një fond privat investimesh i regjistruar në Gjenevë, u lidh me arkitektin Gjergj Shkodra për t'i porositur projektin e një hoteli me pesë yje buzë Adriatikut. Gjergj Shkodra as nuk i kishte pyetur investitorët si e kishin gjetur emrin e tij. Atë e kishte pushtuar sakaq ankthi. Një projekt i tillë shkonte shumë përtej

njohurive të tij në arkitekturë. Por ai nuk mund ta linte rastin t'i ikte. Nuk ishte nga ata që ngrinin duart Gjergj Shkodra. Për më tepër kur ishin aq shumë para në lojë.

Duke ndjekur përfytyrimin e shkrimtarit finlandez, ish-specialisti për ndërtimin e bunkerëve në Ushtrinë Popullore Shqiptare, Gjergj Shkodra, tashmë i pagëzuar arkitekt në fushën e hotelerisë për turistë, duhej të ndërmerre një udhëtim mësikor në Perëndim para se t'i hynte punës për projektin. Gjergj Shkodra as me sy nuk kishte parë një hotel si ai që i kërkohej të vizatonte. Gjatë këtij udhëtimi ai do të gjente një model, të cilin sigurisht që do e përshtaste me brigjet me shkëmbinj gëlqerorë të shpëlarë nga ujërat e kripura të Adriatikut të jugut, ku investitorët kishin blerë truallin. Përvoja më shumë se dhjetë vjeçare e shërbimit në ushtri e ndihmoi të hartonte një plan të mirë për udhëtimin, ku duhej të mbante parasysh të kursente kohën dhe të pakësonte shpenzimet. U kërkoi investitorëve të projektit një paradhënie, të cilën ata ia dhanë pa ngurrim. Gjithnjë me pikësynimin e qartë për të fituar kohë dhe ulur shpenzimet e udhëtimit, ama pa dëmtuar punën, ai përcaktoi paraprakisht vendin, ku do e kërkonte modelin e hotelit që do të vizatonte. Kriteri i vetëm për këtë zgjedhje ishte: hotelet më të shtrenjta janë detyrimisht edhe hotelet më të mira. Me sa kishte mundur Gjergj Shkodra të mësonte, hotelet më të shtrenjta ishin në Monako. Një natë në këto hotele kushtonte aq sa një shqiptar i paguar shumë mirë, një ministër për shembull, nuk i merrte në nëntë muaj në ato fillime të hapjes së vendit. Ai vendosi të shkonte në Monako. I duhej, sigurisht, edhe një përkthyes. Gjermanishtja e tij ishte e varfër. Dhe, për më keq, në Monako nuk flitej gjermanisht. Në këtë principatë të çuditshme flitej frëngjisht. Por bënte punë edhe anglishtja. E mira do të ishte që përkthyesi i tij t'i fliste të dyja gjuhët.

Në sinopsin e shkrimtarit, për një arsye që shkrimtari nuk ua kishte shpjeguar aktorëve të tij, ishte parashikuar që Gjergj Shkodra, në udhëtimin e tij inisiatik drejt Monakos, të kalonte nga Beogradi, ku edhe do të njihej me Girill Jugrazarin, një

taksist ky me origjinë serbo-boshnjake, por që fliste shumë gjuhë, midis të cilave edhe gjermanisht për t'u marrë vesh me Gjergj Shkodrën, edhe anglisht e frëngjisht siç ishte e pëlqyeshme për ekspeditën e tij kërkimore në Monako. Ai pranon menjëherë ta ndjekë Gjergj Shkodrën në këtë rrokme, ku do të mbante njëherësh detyrën e përkthyesit e të sekretarit. Serbo-boshnjaku kishte edhe një cilësi tjetër, që ia shtonte vlerat e që Gjergj Shkodra mendoi se do u shërbente për të fituar më shpejt simpatinë e njerëzve në Monako: ai ishte një kavalier qejfli, i gatshëm të ngrihej në valle pa pritur t'i luten. Dhe i kërcente me zhdërvjelltësi të madhe vallet dinamike të të gjitha kombësive të Jugosllavisë. Gjergj Shkodra nuk mund ta mendonte pa një tavernë të madhe hotelin e fisëm në Monako, ku do të ngulej i shoqëruar nga bashkëpunëtori i tij, me qëllimin e fshehtë për t'i vjedhur planimetrinë. Në tavernë do të hahej e pihej, me muzikë e vallëzim. Përkthyesi, me talentin e tij të shquar si valltar, do e ndihmonte ekipin të fitonte simpatinë e personelit të ngarkuar për të ruajtur sekretin e projektit, që e bënte atë hotel unik në botë. Ky, pra, ishte plani i ndërmarrjes së Gjergj Shkodrës, i hartuar deri në hollësi nga shkrimtari finlandez, e që po zbatohet me një saktësi dhe njëherësh krijueshmëri të denjë për kulturën e punës të një luteriani. Nga bashkatdhetari im zeshkan, i ashtuquajtur tashmë Gjergj Shkodra, unë mësova, madje, se atë mbrëmje ky Gjergj Shkodra do të darkonte me një gjeodet plak finlandez, ish-tankist gjatë Luftës së Dytë Botërore, i rrjedhur tashmë aq sa nuk mbante mend emrin e vet, por që mbante mend për bukuri teknikat mbrojtëse dhe shkatërruese në betejat tankiste si kundër nazistëve edhe kundër sovjetikëve. Gjeodeti në pension, të cilin Gjergj Shkodra do e njihte me emrin Taavetti Rytönen, mbante gjithashtu mend për bukuri teknikat e përdorura në gjeodezi në vitet pesëdhjetë-gjashtëdhjetë në vendin e tij. Gjergj Shkodra bashkë me ndihmësin e vet përkthyes do të pinin pa kursim atë mbrëmje nga të gjitha llojet e alkoolëve, të qerasur me gjasme nga gjeodeti, i cili do të kishte me vete po ashtu një taksist, për të cilin besonte se ishte doktori i tij.

Gjergj Shkodra e priste me kënaqësi të veçantë atë mbrëmje për arsye të pijeve që do të ishin me bollëk. Ai nuk kishte vënë në gojë pikë alkooli qysh kur kishte filluar këtë punë. Por e kishte edhe një ankth. Me gjeodetin finlandez do të duhej të shkëmbeinin

mendime rreth taktikave dhe stratagjemave të përdorura nga tankistët finlandezë gjatë luftës së fundit dhe atyre staliniste, të përvetësuar nga ushtria shqiptare me ardhjen e komunistëve në pushtet. Ishte një fushë, ku ai nuk kishte njohuri fare e ku sinopsisi i shkrimtarit nuk e ndihmonte shumë. Për pjesën tjetër të bisedës, aty ku do të ballafaqoheshin njohuritë e shkollës shqiptare të gjeodezisë me njohuritë që zotëronte Taaveti Rytkönen, shkrimtari kishte dhënë më shumë tekst. Edhe vetë Gjergj Shkodra ishte pak më i ditur në këtë fushë, por dituritë e tij nuk do i hynin në punë. Shkrimtari kishte vendosur që Gjergj Shkodra t'i tregonte kryemjeshtrit finlandez se teknikat gjeodeze në Shqipëri ishin pothuajse primitive dhe, për më tepër, shumë të ngatërruara, sepse mbështeteshin në tri shkolla të ndryshme. Baza themeluese e njohurive ishte shkolla kapitaliste e fillimit të shekullit të kaluar, e cila ishte hedhur poshtë pas Luftës së Dytë Botërore për t'u zëvendësuar nga shkolla ruse. Me prishjen e Shqipërisë me Bashkimin Sovjetik, edhe kjo shkollë ishte hedhur poshtë, për t'i lënë vendin shkollës kineze. Gjergj Shkodrës i pëlqente veçanërisht fjalia: "Gjeodezët shqiptare veshin këpucë kaba, ose të themi më mirë, jo këpucë, por çizme për në mal, të cilat kanë shoje të vjetra evropiane, qafa ruse dhe thembra kineze". Taavetti Rytkönen do të fillonte t'i mësonte Gjergj Shkodrës teknikat e përdorura në gjeodezinë finlandeze në vitet pesëdhjetë-gjashtëdhjetë. Gjergj Shkodra duhej të tregohej i kënaqur me njohuritë që po merrte dhe të luante rolin e nxënësit të zellshëm, duke mbajtur shënime në gjuhën amtare, sado që bisedën do e bënin në gjermanisht, duke lënë kështu krejt të lirë përkthyesin të argëtohet me kolegun e vet taksist e të cilin gjeodeti i rrjedhur e paraqiste si mjekun e vet. Sado që nuk e pohoi, Gjergj Shkodra e kishte një fije zili ndaj bashkëpunëtorit të vet, pse ai do e shijonte lirisht mbrëmjen, pa arsye për ta kufizuar pirjen. Madje vetë roli e parashikonte që në fund të mbrëmjes përkthyesi të ishte i dehur.

Taavetti Rytkönen do i shpjegonte Gjergj Shkodrës përdorimin e goniometrave, do i tregonte njësitë për matjen e këndeve, do i fliste për teodolitët, për busullat e për tangjentet. Gjergj Shkodra do i qahej bashkëbiseduesit finlandez se teodoliti kinez nuk ishte shumë i saktë. Apo ndoshta e kishin fajin ata që

bënin matjet? U kishte ndodhur t'i ngrinin bunkerët e qendrat e zjarrit edhe njëqind metra larg vendit të caktuar në hartë. Taavetti Rytkönen do e ngushëllonte, ose do të dukej sikur e ngushëllonte: gabimet e topometrisë mund të kenë pasoja shumë të rënda në krahinat malore, ku ndryshimet e lartësisë ishin të ndjeshme. Gjergj Shkodra duhej të tregohej veçanërisht i vëmendshëm për matjen e disniveleve. Ai kishte për detyrë të nxirrte në pah përpara gjeodetit veteran finlandez sa të cekëta e të gabuara ishin njohuritë e tij për metodat barometrike dhe sistemi trigonometrik, për të cilin do i fliste gjeodeti pensionist finlandez, duhej të ngjante me një diçka krejt të re për të. Gjatë studimeve të tij, siç edhe gjatë shërbimit në Ushtrinë Popullore Shqiptare, ai sigurisht që as me sy nuk kishte parë ndonjë teodolit xhiroskopik. Gjergj Shkodra nuk do e fshihte ngazëllimin për mësimet e reja që po merrte, për më tepër krejt falas nga një profesor i zoti dhe i motivuar siç mund të jenë në detyrë vetëm profesorët finlandezë. Mësimi i metodës horizontale ishte shumë teknik, që shkon të përkthehet edhe tepër abstrakt dhe i mërzitshëm. Për Gjergj Shkodrën do të ishte rasti të tregonte mendjemprehtësinë e vet duke e përvetësuar me shpejtësi. Herë pas here, gjatë darkës, ndërkohë që “përkthyesi” i tij bashkë me “mjekun” e kryemjeshtrit gjeodet zbraznin gotat me alkool nga më të mirat, Gjergj Shkodra, i shoqëruar plot dashamirësi nga mësuesi i vet, do të dilnin në oborrin e pasmë të hotelit për të zbatuar njohuritë. Lokalizmi i hotelit do të ishte një ushtrim për ta ngritur peshë shpirtin e Gjergj Shkodrës. Para syve të shkrimtarit, i cili do të mbante pareshtur shënime në një bllok të vogël me kapakë të kuq, kryemjeshtri finlandez, i ndihmuar nga çiraku i tij shqiptar, do të përcaktonin me saktësi pozicionin e hotelit në univers. Pastaj Taavetti Rytkönen do të vizatonte një prerje gjatësore, të cilën do e përmbledhte me thjeshtësinë më të madhe në ekuacionet e mëposhtme:

$$\Delta x_{13} = \frac{\sum y_{12} - \sum x_{12} \tan t_{23}}{\tan t_{13} - \tan t_{23}}$$

$$\Delta y_{13} = \Delta x_{13} \tan t_{13}$$

I ashtuquajturi Gjergj Shkodra kishte nxjerrë ndërkohë nga xhepi letrën, ku shënoheshin ekuacionet në fjalë, të cilat nuk arrinte t'i mbante përmendësh dhe ma zgjati mua t'i hidhja një sy. Unë nuk e mora. Por, duke përfituar nga kjo ndërprerje, i thashë:

- Si do t'ia bëni për t'u dukur normal gjithë mbrëmjen para një të rrjedhuri?

Ai mori sërish atë hijen e një burri në siklet për të shfaqësuar përgjegjësinë e dikujt tjetër dhe m'u përgjigj:

- Nuk besoj të jetë i rrjedhur. Do të jetë dikush si unë, por finlandez, i thirrur për të krijuar përmes lojës teatrore maketin e historisë si një përgatitje e shkrimtarit të madh për të nisur shkrimin e romanit me bindjen se ka prekur realitetin.

Mua më mbetet edhe një pyetje para se të ndaheshim. Dhe ia bëra:

- Si ju kanë gjetur për një kontratë të tillë?

- Është një agjenci e çuditshme në Bruksel. E ka krijuar një shqiptar. Gjen njerëzit e përshtatshëm për të kryer ca punëra si kjo që më është ngarkuar mua, të cilave s'u del njeri për zot nëpër Europë. Ka bërë shumë emër dhe fiton mirë.

- Mos quhet Bilal Barzezi ky shqiptari?

- Po, - u hodh zeshkani i parruar, emrin e vërtetë të të cilit nuk e kisha mësuar dhe as që kisha kureshtje ta mësoja. - E njihni? Me siguri që e njihni. Qeveria di gjithçka.

Gjithë këtë histori - sipas mendimit tim argëtuese - unë ia tregova eprorit tim gjatë njërit nga pushimet për kafe midis seancave të samitit. Ai lëshoi një "hë-hë!" grykore, që mund të merrej edhe si një qeshje e mbytur. Nuk më tha asgjë më shumë dhe as unë nuk kisha ndonjë arsye për t'i kërkuar komente. Por gjërat do të pezmatoheshin, aq sa të plaste ai sherr që plasi, në fillim të pasdites, kur samiti ishte përmbyllur tashmë bashkë me drekën zyrtare dhe një pjesë e kryetarëve të shteteve apo qeverive - ata që kishin avionët e tyre - po linin hotelin me nxitim. Ne kishim fluturim vetëm të nesërmen në mëngjes. Bashkë me eprorin tim u ndalëm në ndenjëset e hollit të hotelit para se të

ngjiteshim në dhomë. Ishte rasti, si zakonisht, të shkëmbenim ndonjë mendim mbi bisedat që kishim pasur secili gjatë drekës me përfaqësues të vendeve të ndryshme, me të cilët ishim gjendur në tryezë, por edhe për t'u përshëndetur me ata që po largoheshin. Eprori im dukej krejt i kënaqur dhe i shtendosur. Do të kishim kohë për një pushim të mirë të pasdrekes, siç eprori im nuk ia lejonte shpesh vetes gjatë ditëve të zakonshme të punëve në Tiranë. Ai nuk më kishte thënë ndonjë dëshirë për takime informale, që mund të kishte në fund të pasdites e gjatë mbrëmjes me përfaqësues vendesh apo organizatash ndërkombëtare, të cilët do e kalonin natën në hotel ashtu si ne.

Në këtë kohë më zuri syri trininë romaneske: dy zeshkanët e parruar ballkanas dhe shkrimtarin e madh finlandez, i cili mbante pareshtur shënimet e veta në bllokun e vogël me kapakë të kuq. Unë i ndoqa me vështrim një grimë herë para se të tërhiqja vëmendjen e eprorit tim drejt tyre. Zeshkani i ashtuquajtur Gjergj Shkodra, i ndihmuar nga zeshkani mustaqeli serbo-boshnjak, i ashtuquajtur për nevojat e eksperimentit letar Girill Jugrazar- "përkthyesi" - i përqendruar sa s'ka më, po maste me metrin e vet metalik gjerësinë e krahut të djathtë të hollit, atje ku fillonte një sallë e madhe mbledhjes, e cila ndahej me hollin me një stenë prej qelqi të mbuluar nga brenda me perde të trasha kadifeje bojë kafe. Gjergj Shkodra i shqiptonte në gjermanisht të dhënat, përkthyesi i përcillte në anglisht dhe shkrimtari i përsëriste me zë të lartë, si për t'u siguruar se kishte dëgjuar mirë, para se t'i shënonte në bllokun e vet të vogël me kapakë të kuq. Në një çast Gjergj Shkodra ndërpreu punën. Pranë tij po kalonte njëri nga punonjësit e shërbimit, një djalë i ri i qeshur. Me ndihmën e përkthyesit, ai e pyeti, gjithë seriozitet, punonjësin e shërbimit se çfarë trashësie kishin muret e brendshme të hotelit, ato që ndanin mjediset nga njëri - tjetri. Shkrimtari u zu në befasi dhe mbylli bllokun e vogël me kapakë të kuq. Ma thotë mendja se po kërkonte fjalën qortuese për arkitektin shqiptar. Punonjësi i shërbimit mbeti si i ngrirë nga habia. Ai mblodhi supet dhe iu lut klientit të përsëriste pyetjen. Gjergj Shkodra, pa asnjë shenjë turbullimi, kërkoi përsëri të dinte çfarë trashësie kishin muret e brendshme

të hotelit, ato që ndanin mjediset njëri nga tjetri. Punonjësi i shërbimit e kapërceu hutimin dhe iu përgjigj:

- Nuk është pjesë e detyrës time ta di. Pyesni në recepsion, ju lutem! - Dhe bëri të largohet.

Por Gjergj Shkodra, pa kurrfarë sekëlldie, i drejtoi pyetjen e dytë:

- Po muret e jashtme, ato mbajtëse, çfarë trashësie kanë?

Punonjësi i shërbimit arriti me mjeshtëri ta fshihte bezdinë dhe iu përgjigj se edhe për këtë pyetje ai duhej të drejtohej në recepsion.

Shkrimtari, që e kuptoi më në fund ç'po ndodhte, shpërtheu, sa të dëgjohej deri te ne:

- Bravo, Gjergj, Bravo! Ky ishte një improvizim i mrekullueshëm. Ti po e pasuron subjektin tim. Bravo!

Eprori im e dinte tashmë kush ishin ata tre burra, e kishte dëgjuar me veshët e vet bisedën e të ashtuquajturit Gjergj Shkodra me punonjësin e shërbimit si dhe shpërthimin e ngazëllimit të shkrimtarit. Eprori im po ziente. U soll me tërë trupin nga unë, mbështeti fort dorën te bërryli im dhe më tha me një zë thellësisht të acaruar:

- Shko tregoji vendin! - Unë e mora me mend se fjalën e kishte për shkrimtarin e madh finlandez.

- Nuk ka punë me ne, - i ktheva, ndërsa një valë e qeshure po më ngjitej nga fundi i kraharorit.

- Ashtu mendon ti, i dashur Zotni? Ai po vë në lojë kombin tonë, inteligjencën e tij. Ne e kemi për detyrë t'i dalim zot. Ti më së pari si shkrimtar që je. - Eprori im vazhdonte të më shtrëngonte bërrylin.

Unë arrita ta mbys valën e të qeshurës. Ishte hera e parë gjithë këto vite që eprori im kujtohej për përkatësinë time në familjen e shkrimtarëve.

- Unë nuk jam shkrimtar këtu. Jam ministër dhe nuk bëj sherr me një shkrimtar, - ia preva shkurt. Ishte hera e parë gjithashtu që unë e kundërshtoja kaq prerë.

- Unë të urdhëroj, - vazhdoi ai i skuqur krejt.

- Unë nuk e zbatoj një urdhër të tillë, - iu përgjigja me një qetësi të pabesueshme dhe lëviza krahun për të liruar bërrylin, ku gishtërinjtë e eprorit tim ishin mbërthyer si darë.

- Do të mbash përgjegjësi para kombit dhe Historisë, - tha ai dhe brofi në këmbë. Unë u përpoqa më kot ta mbaj dhe e ndoqa pas.

Me pesë hapa ai kishte mbërritur para shkrimtarit të madh finlandez, i cili, i përfshirë thellësisht në punën e vet, kuptoi se diçka nuk shkonte vetëm pasi vuri re të ashtuquajturin Gjergj Shkodra, i cili kishte ngrirë në një drejtqëndrim ushtarak, që nuk i shkonte fare me veshjen e shkujdesur dhe mjekrën e paarruar. Metri metalik, i shpëstjellë, dergjej për tokë si zvarranik i ngordhur.

- Kush jeni ju? - iu drejtua shkrimtari i madh eprorit tim.

- Unë jam ai që ta bëj faqen më të zezë se sholla e këpucëve të tua, - iu kthye eprori im. - Një racist si ti, një albanofob, meriton kaq e më shumë. Dëgjove?

Unë u përpoqa ta tërhiqja eprorin tim. E dija se kur ishte kështu i nxehur, nuk bënëin derman fjalët. Shkrimtari i madh finlandez nuk e kishte humbur ende gjakftohtësinë. Ai e solli kokën një herë nga unë, një herë nga Gjergj Shkodra dhe tha:

- I çmendur është ky? Ore, kush është ky, që më quan mua albanofob? Nga më nxori mua racist ky?

- Një njeri që përçmon inteligjencën e një kombi tjetër është racist e bir racisti. Por dije, një mendje e mbrapshtë si ti nuk mund ta pakësojë as sa një fije floku nderimin tim të lartë për kombin heroik finlandez. - Eprori im po e mblidhte pak veten. Pata përshtypjen se do e linte me aq sherrin. Por ai u drejtua nga i ashtuquajturin Gjergj Shkodra, i cili vazhdonte i ngrirë në drejtqëndrimin e vet prej ish-ushtaraku. - Dhe ti, turp të kesh që ke pranuar të bëhesh pjesë e një loje poshtëruese për kombin tënd, - i tha në shqip, gjithnjë me zemërim, por pa atë hakërrimën e parë. - Je shitë për dy lek. Të tillë ushtarakë i la Shqipërisë trashëgimi Enver Hoxha. Turp për ty dhe për atin tënd shpirtëror!

- Si urdhëron! - iu përgjigj me një zë të mekur i ashtuquajturin Gjergj Shkodra.

Unë arrita më në fund ta tërheq eprorin tim, ndërsa shkrimtari i madh finlandez po i kërkonte diçka me të pëshpëritur përkthyesit. Me siguri e pyeste për çfarë i kishte thënë në shqip eprori im ish-inxhinierit të xhenios në Ushtrinë Popullore Shqiptare. Arrita të

dëgjoj që shkrimtari përmendi Enver Hoxhën. Ndërsa përkthyesi i përgjigjej se nuk kishte kuptuar asgjë e se nuk dinte shqip. Ndërsa Gjergj Shkodra nuk lëvizte nga drejtqëndrimi i tij. Shkrimtari i madh finlandez e shau përkthyesin me një fjalë që më vjen rëndë ta sjell në këtë tregim. Pastaj shtoi:

- Unë të kam paguar kot gjithë këto ditë. Dëgjove? Unë di vetë gjermanisht shumë më mirë se ti. Nuk kam më nevojë për ty. - Dhe i ktheu shpinën.

Grill Jugrazar i vrapoi nga prapa duke i premtuar me një zë lutës se do të mësonte pa vonesë edhe shqip.

Duhet të kem qenë vërtet shumë i hutuar përderisa vija të hamendësoja se ajo femër ishte ndonjëra nga asistentet e zellshme të shkrimtarit finlandez, me të cilin eprori im sapo kishte bërë një nga ato sherret që vetëm mendja e tij mund të sajonte. Pasi më ishte paraqitur sipas mënyrës së saj, ajo vazhdonte të më rrinte varur mbi kokë, pa dhënë asnjë shenjë padurimi për vonesën e reagimit tim. Unë ndjehesha aq i plogështuar, sa nuk kisha vullnet as të pyesja veten se ç'dreqin mund të kërkonte ajo femër (ose punëdhënësi i saj) nga unë tashmë. Me shkoi sidoqoftë nëpër mend se ajo po lypte ndihmën time për një sqarim midis eprorit tim dhe punëdhënësit të saj, që do të nënkuptonte edhe një pajtim midis tyre. Ose më e keqja: punëdhënësi i saj kishte vendosur ta çonte çështjen në gjyq dhe mua më donte si dëshmitar. Ashtu siç ndjehesha unë i mbushur me bezdi për sa i përkiste asaj meseleje, nuk do e pranoja njërin as tjetrin rol. Nuk do të pranoja të bëhesha as ndërmjetës si bartës i paqes dhe as dëshmitar si bartës i të vërtetës. Nuk kishte më vend për mua as për të hyrë midis të dyve e as për të marrë anën e njërit apo të tjetrit. Secili prej të dyve kishte të vërtetën e tij dhe ishin dy të vërteta kaq larg njëra tjetrës, sa nuk do mund të afroheshin më e aq më pak të shkriheshin në një as me ndërmjetës pajtues e as me gjykatës.

Ndërkohë, ajo femra e varur mbi kokën time, e cila shfaqej thellësisht e bindur se unë duhej ta njihja aq mirë, sa do të ishte e tepërt nga ana e saj të më jepte kartëvizitën, ajo doemos që priste nga unë një reagim. Kisha dy zgjedhje, secila e mjaftueshme. E para do të ishte mbajtja larg e asaj femre me një përgjigje të ftohtë, përcmuese, për të mos i dhënë rast ta zërë në gojë para meje sherrin e eprorit tim me punëdhënësin e saj. Ishte një gjë që dija ta bëja mirë dhe pa ndonjë stërmundim të ndjeshëm. Zgjedhja e dytë do të më çonte në një rrugë krejt të kundërt: të nisja me të një bisedë joshëse, të derdhja në këtë bisedë gjithë ëmbëlsinë, misterin dhe tensionin e brendshëm, që do e thyenin vendosmërinë profesionale të asaj asistenteje, do të zgjonin brenda saj femrën, e tillë siç mund të ishte ajo për një çast në mëngjes, e vetme si femër përballë vetes në pasqyrë, kur maste sa pika parfum duhej hedhur e në cilën pjesë të trupit. Besoja se kjo femër do e quante të kotë pastaj harxhimin e kohës me mua për të folur rreth sherrit të eprorit tim me punëdhënësin e saj.

Zgjedhjen e parë isha krejt i gatshëm ta zbatoja. Përshtypja e pakëndshme se ajo po vëzhgonte tepelekun e kokës time, ku edhe ishin gjurmët më të qarta të shtyrjes përpara të moshës, më derdhte nëpër skajet e nervave një si përcëllimë, e cila shkatërron sistemin tim të vetëpërmbajtjes. Unë nuk e kisha parë kurrë në pasqyrë dhe as të fotografuar atë pjesë të trupit tim, por e dija me siguri se atje kishin nisur të rralloheshin dukshëm flokët.

Zgjedhja e dytë, ajo që do të më shtynte të nisja me të një bisedë joshëse nënkuptonte të zhbëja paraprakisht atë përshtypjen acaruese që më shpërndante gjithandej nëpër trup vështrimi i saj i ngulur mbi tepelekun e larushitur të kokës time. Përndryshe, nuk do të isha në gjendje për t'ia dhënë të plotë rëndësinë aromës së saj. Do të më pëlqente që teatri i joshjes të fillonte me pohimin nga ana ime të zbulimit që sapo kisha bërë, se një femër me sqimë të vërtetë dallohej edhe te masa në përdorimin e parfumit për të mos e mbytur atë avullin e padukshëm të trupit të vet, në saje të të cilit mbush hapësirën prania e saj femërore. Ishte një qasje e fortë, e dija, ndaj të cilës një femër nuk mund të ishte kurrsesi mospërfillëse. Por kjo qasje ishte edhe e mbarsur me rrezikun të më shfaqte mua hiç më

shumë e as më pak veç si një burrë cipëplatur, që do të thotë se nuk përjashtohej që unë të merrja nga ana e saj një përgjigje të përshtatshme për një burrë cipëplatur. Pas sherrit të zhurmshëm të eprorit tim me shkrimtarin finlandez, grepacimi im me asistenten e shkrimtarit do të tingëllonte si një skandal i vërtetë. Gjithë faji, me të drejtë, do të binte mbi mua. Një grua, edhe krejt e panjohur, mund të lëvdohej, pa u shkelur mirësjellja, për bukurinë e saj, për elegancën në veshje, për krehjen me shije, për mençurinë, por jo për aromën që e shoqëronin bukurinë apo elegancën e saj. Aromën, qoftë edhe parfumi, i cili blihej në pazar siç edhe bliheshin veshjet, shënonte cakun e intimitetit të saj e ku ndërhyrja e një të panjohuri, - i tillë isha unë për të, pavarësisht afrisë, që ajo kishte dashur të më tregonte duke më thënë si fjalë të parë se unë e njihja aq sa edhe shkëmbimi i kartëvizitave ishte i panevojshëm - nuk lejohej. Aq më e rëndë pastaj do të ishte sikur unë t'i përmendja asaj edhe avullin e padukshëm, që trupi i saj shpërndante përreth si një brerore të patjetërsueshme femërie e që unë e ndjeja si e kishte pushtuar të paktën atë pjesë të ajrit që prekte shqisën time te nuhatjes.

Më mbetej si më e përshtatshme ta merrja zët, me një fjalë ta largoja sa pa i dhënë ende kohë të më zbrazej. Nuk kisha as dëshirë e as fuqi t'i bëja ballë një grepacimi me të. Ajo thirrja stërgjyshore, e cila vazhdonte të pikonte helm në një skutë të largët të vetëdijes time pse nuk i kisha dalë për zot bashkudhëtarit tim, më kujtoi se vetëm do e trashja fajin e parë duke u grepacuar me një grua qoftë kjo edhe një finlandeze, domethënë bashkëkombëse e atij që kishte shkaktuar zemërimin e furishëm të eprorit tim. Nuk kisha njohur kurrë, për mirë e as për keq, ndonjë finlandeze dhe nuk isha në gjendje të përfytyroja sadopak si do të ishte një degamë e tillë. Vështrimi i saj nga lart nisi të më lëshonte mbi tepelek një si mori buburrecash, që më kacavirreshin nëpër rrënjët e flokëve të rralluar. Shkunda instinktivisht kokën "bërr". Dhe po ashtu instinktivisht kërkova ndërkohë me sy mbi tryezën përpara meje të shoh si do të rrëzoheshin breshëri ato shtazë të vogla të zeza shumëkëmbëshe. Isha shumë i tendosur. Ajo ishte në anën time të djathtë. Solla kokën drejt saj dhe përkula qafën majtas me qëllimin për ta rrokur mirë me vështrim.

Më shpërtheu sakaq një e qeshur, që edhe më shtendosi si me magji. Nuk bëra asnjë përpjekje të përmbahesha, edhe pse i vetëdijshëm që po gaboja. Në vetvete një shpërthim i tillë i papritur i të qeshurës duhej të ishte pastërtisht shenjë çmendurie. Për më keq kur këtë të qeshur ia përplasja në fytyrë një gruaje të panjohur, qoftë kjo edhe asistente e një burri, të cilin eprori im sapo e kishte akuzuar për racizëm antishqiptar. Ajo ishte afruar drejt meje afërmendsh për të më thënë diçka të rëndësishme, ndoshta madje shumë të rëndësishme, duke dhuruar paraprakisht për nuhatjen time një aromë të mrekullueshme. I kisha hequr sakaq vetes kështu të drejtën për ta pyetur me çudi pse duhej patjetër që unë ta njihja. Çuditja ime, përpara sigurisë së saj në vete, - jo çuditja e atij që zbulon dobësimin e parakohshëm të kujtesës së vet, por çuditja e një burri të ndeshur befaz me një leje të papërligjur, që ajo femër po i jepte vetes në qasjen ndaj tij, - çuditja ime, pra, tek e pyesja se përse duhej me patjetër që unë ta njihja aq sa të bëhej i panevojshëm shkëmbimi i kartëvizitave, do të më kishte dhënë ndërkaq një epërsi të dobishme për vazhdimin e bisedës, gjithnjë në qëllim të shmangies së degamës. Qoftë edhe si mirënjohje për një farë turbullire të fshehtë që më kishte dhënë hallakatja e shkurtër nëpër atë kufirin e padallueshëm midis parfumit të zgjedhur nga ajo sipas shijes së vet dhe të hedhur nga ajo me dorën e vet ndoshta në rrëzë të veshit, ndoshta nën mjekër dhe, me siguri, në atë gropëzën si kafshim midis gjinjve dhe atij avullit të vetvetishëm të trupit të saj femëror, lindur bashkë me të - dhuratë hyjnore - unë ia kisha asaj detyrim një shpjegim të menjëhershëm për të qeshurën. Më tej i takonte asaj të më mirëkuptonte ose jo. Por edhe ashtu siç ishim vendosur ne, - ajo në këmbë, e varur mbi kokën time dhe unë i ulur e me qafën të përkulur majtas, - nuk mund të flitej. I tregova me dorë kolltukun përballë. Ajo i hodhi një vështrim të shpejtë, por nuk lëvizi. Nuk donte të ulej përballë meje dhe kishte të drejtë. Unë e kisha lënduar pa asnjë arsye duke i zbrazur në fytyrë, si gërfyell, një shakullimë haharisjeje. Ajo nuk mund ta merrte me mend arsyen e të qeshurës time. Unë bëra atë mbledhjen që i nevojitej trupit për t'u shkëputur nga kolltuku. Do të ngrihesha.

Ajo më vuri dorën në sup dhe peshoi mirë aty, gjë që duhej ta kuptoja: mos u ngri! Ajo po merrte komandën. Mua nuk më lejohej të ngrihesha. Qafa ime e përkulur majtas, me qëllimin për ta rrokur më mirë në vështrim, po jepte shenja lodhjeje. Ndërsa shakullima e të qeshurës time ulej e ngrihej si një motor që nuk e merr mirë karburantin.

- Ju duhet të më pyesni përse qesh, - arrita t'i drejtohem, me shpresë se e folura do të më qetësonte disi.

- Përse qeshni? - nuk vonoi ajo pyetjen.

Unë nxitova t'i tregoj se të mbrëmshmen, në një nga kanalet televizive franceze, kisha parë një reportazh mbi ceremoninë e edicionit të 22 të Çmimit "IgNobel". Ndoshta ajo e dinte ç'ishte ky çmim. Madje ndoshta e kishte parë edhe reportazhin në fjalë.

Ajo nuk e kishte parë reportazhin në fjalë dhe nuk e dinte ç'ishte çmimi "IgNobel". Nuk kishte dëgjuar kurrë të flitej për të.

As unë nuk kisha dëgjuar kurrë të flitej për një çmim të tillë deri të mbrëmshmen. Ishin në njëfarë mënyre çmimet "AntiNobel", që jepeshin për shkencat dhe jo në një vend dosido, por bash në rrethosën e mirënjohur të Universitetit të Harvardit në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Shpërbleheshin me këtë rast autorët e kërkimeve shkencore më torollake anembanë botës. Sivjet, në fushën e psikologjisë, çmimin "IgNobel" e mori një ekip i përzier me studiues nga Holanda, Rusia dhe Peruja për punimin me temë: "Të përkulesh majtas, Kulla Eiffel të ngjan më e vogël". Unë e përcolla tregimin tim me një të qeshur të fundit, që u fik shpejt. Ajo nuk po qeshte. Më kishte ngulur një vështrim të çmeritur, të cilin nuk dija si ta merrja.

- Nuk më besoni? Shkoni në internet në <http://www.improbable.com/ig/>.

- As që më duhet. Ta zëmë se ju besova.

- Unë po ju vështroj me kokën të përkulur majtas, - i thashë më shpresën për ta sjellë vëmendjen e saj tek arsyeja e të qeshurës time.

- Unë duhet t'ju dukem e vogël fare, - ma ktheu. - Një thërrime. - Dhe vuri më në fund buzën në gaz.

- Në fakt, mua vetë me kokën kështu të përkulur majtas, po më duket vetja si njëri nga ata psikologët e rrjedhur, që

ndërmarrin kërkime të tilla. - Doja ta mbaja me patjetër gjallë buzagazin e saj.

- Mua ata nuk më duken hiç të rrjedhur, - m'u kthye ajo, serioze. - Përkundrazi. Ata i japin njeriut të sotëm dhe sidomos njeriut të nesërm një mësim shumë të dobishëm. Pasurojnë drejtpërdrejt aftësinë e tij për të njohur vetveten.

Aty për aty unë nuk e pyeta pse ishte aq e bindur se ai ekip aq i përzier psikologësh - rusë, holandezë e peruanë - me një zbulim të tillë, për të cilin kishte fituar çmimin "IgNobel", i kishte dhënë njeriut të sotëm e sidomos atij të nesërmen një mësim shumë të dobishëm për ta njohur vetveten. Mendova se ishte një nga ato kundërshtimet, nga ana e saj, për të forcuar pushtetin mbi mua, të cilin ajo e dinte se kishte filluar tashmë ta merrte. Ndërsa unë vetë besoja se kisha arritur një fitore të rëndësishme duke e tërhequr në një bisedë pa lidhje me sherrin e eprorit tim me punëdhënësin e saj. Dhe kaq më mjaftonte.

Më pas, gjatë po asaj pasditeje, ajo do të ngulte përsëri këmbë dhe me një seriozitet që nuk linte mëdyshje, për bindjet e saj se një zbulim i tillë ishte një pasurim i çmuar i aftësive të njeriut për ta njohur vetveten. Për mua, aty për aty, nuk paraqisnin ndonjë rëndësi argumentet e saj, ndaj dhe as që më shkoi nëpër mend ta kundërshtoja, apo qoftë edhe të lëshoja ndonjë nënqeshje, e cila të keqkuptohej si nënvleftësim për shtjellimet e saj. Këta muajt e fundit, teksa rropatesha për t'i gjetur një ekuilibër të përshtatshëm historisë që po shkruaj, m'u kujtua përsëri frymëzimi i saj i paparashikuar. Sipas kriterit tim, e që sigurisht ishte kriteri i një politikani, unë e kisha vlerësuar punën e atij grupi ndërkombëtar psikologësh si torollake vetëm pse të tillë e kishin vlerësuar shumica e atyre që ishin njohur me atë punë, përfshirë këtu edhe një juri, e cila apriori duhej të ishte krejt e besueshme përderisa gjykimin e vet e shpallte brenda rrethores së Universitetit të Harvardit. Në këto rrethana do të kishte qenë e kotë që unë ta lodhja trurin për të pasur gjykimin tim. Përfshirja me shumicën, pavarësisht përse bëhej fjalë, ishte kthyer tek unë në zakon, që

ma thjeshtonte jetën, por edhe ma varfëronte, pa e kuptuar, imagjinatën. Ndërsa për atë femër, e cila me mënyrën time të të menduarit takohej vetëm në një pikë- si votuese, - nuk kishte asnjë domethënie paraprake nëse bënte pjesë te shumica apo te pakica. Kështu ndodh kur mendon me kokën tënde, thashë me vete pa e fshehur një fije adhurimi për atë femër.

Duke menduar me kokën e vet, ajo po më shpjegonte se jo më kot ata psikologë kishin marrë për objekt studimi pikërisht kullën Eiffel, e njohur anembanë botës, një ngrehinë fund e krye prej hekuri, dhe hekur në ngjyrën e vet natyrale, që do të thotë pa bojatisje dhe pa përzierje me materiale të tjera qelqi apo sintetike siç do të kishte qenë, bie fjala, Qendra Kulturore “Georges Pompidou”, të cilat mund ta rrejnë syrin. Psikologët kanë zgjedhur kështu shembullin më të pakundërshtueshëm për t’i thënë njeriut se ai është ditë e natë pre e një iluzioni, të cilin, për më tepër, dashje pa dashje njeriu e mbart gjithë kohën në vete si një kurth për vetveten. Domethënë se njeriu, për gabimet e tij në perceptimin e hapësirës, nuk është doemos viktimë e ndonjë mashtrimi optik, në të cilin bota jashtë tij e ka mbërthyer si në një rrjetë magjie me qëllimin për t’i kujtuar vogëlsinë dhe pafuqinë, që mishëron. Ja, mjaft që të përkulesh pak majtas dhe gjërat përreth të shfaqen ndryshe nga ç’janë në realitetin e tyre material. Deri edhe vetë Kulla Eiffel zvogëlohet.

Unë, pra, nuk e pyeta aty për aty përse ajo ishte aq e bindur se ai ekip ndërkombëtarisht i përzier psikologësh i kishte dhënë me zbulimin e vet njeriut të sotëm e sidomos atij të nesërm një mësim të dobishëm. As që më duhej. Kisha arritur qëllimin tim: të thyeja vendosmërinë e saj fillestare për t’u hakmarrë mbi mua për fyerjet, që eprori im kishte lëshuar mbi punëdhënësin e saj. I vetëdijsëm se kjo ishte fitorja ime e parë, por jo përfundimtare për të shmangur sherrin, i hodha një vështrim pajtues e që ishte, në fakt, edhe vështrimi i një burri mbi një femër me një erëzim aq turbullues. Ajo ishte aty, pa asnjë shenjë mërzie pse nuk kishte marrë ende përgjigje nga ana ime nëse ishte e nevojshme apo jo të më jepte kartëvizitën e që sigurisht, sipas saj nënkuptohej që jo, nuk ishte e nevojshme. Unë duhej ta njihja e të sillesha ndaj saj si ndaj një të njohure.

Por unë nuk e njihja, sado që në atë çast do të kisha dashur shumë që ajo të kishte të drejtë qoftë edhe për të mos humbur kohë me paraqitjet e rëndomta. Edhe pse shumë pranë meje, që vazhdoja të rrija ulur, ajo kujdesej t'i jepte trupit një qëndrim të drejtuar mirë për t'ia nxjerrë qartë në pah qafën e gjatë dhe gjinjtë e rrumbullakët e të kërcyer pa tepri nën fustanin e lehtë, në pjesën e epërme, nga supet e deri ku mbarojnë brinjët i zi e më poshtë i bardhë, një e bardhë e zbutur si e zhytur në krem qumështi. Tekstili duhet të jetë prej leshi, thashë me vete nga dëshira për ta zgjatur vëmendjen ndaj veshjes së saj. Vetëm leshi e mban aq ëmbël të bardhën. Fije leshi të thurura patjetër me fije sintetike, ndoshta mëndafsh artificial, shtova duke vrojtuar si derdhej fustani pa u shtrënguar pas trupit, po edhe pa u varur për të marrë rrudha. Madje as rripi i zi në bel nuk ngjante i shtrënguar. Mendova kalimthi se edhe gjinjtë e saj duhej të ishin më të mëdhenj nga ç'i tregonte fustani, i cili në krejt vizatimin e tij, në të vërtetë, shprehte një përmbajtje të matur mirë për sa i përket nxjerrjes në pah të hireve femërore. Ajo ishte kujdesur për t'i treguar huret e veta femërore aq sa ato të mos ishin gjithçka për ta bërë atë tërheqëse si femër. Ky vëzhgim u lidh sakaq në kokën time me atë përpjesëtimin e parfumit, i cili nuk duhej të mbyste avujt e padukshëm, me të cilët ajo pohonte përreth praninë e vet femërore. Pa qenë nevoja të hapte gojën, ajo kishte gjithçka për të më lënë përshtypjen e një femre në zotërim të plotë të vetvetes.

Unë munda t'i vë re këto hollësi joshëse të paraqitjes së saj, madje pata kohë të përfytyroj edhe harkun e thelluar që merrte shpina e saj tek shtynte përpara kraharorin dhe tërhiqte prapa vithet. Ngeja ime e kishte një arsye: nuk isha ende i gatshëm t'i pohoja se jo, nuk njiheshim. Nuk ishim parë kurrë. Të paktën jo në këtë jetë. Ngurroja sikur do të prishja një lojë magjepsjeje, e cila po më pëlqente ta luaja. Vodha edhe një herë me bisht të syrit qafën e saj të gjatë dhe gjoksin e kërcyer aq sa duhej për të theksuar rrumbullakësinë e gjinjve dhe ktheva vështrimin pa ndonjë përqendrim të posaçëm te grumbulli i vogël i njerëzve para derës së ashensorit, të cilët, edhe pse të heshtur, dalloheshin që ishin bashkë. Midis tyre kisha shquar menjëherë Presidentin e Sllovenisë.

Ndërkohë edhe dera e ashensorit u çel dhe Presidenti i Sllovenisë, bashkë me ata që e shoqëronin, u zhduk përbrenda. Vetëm te recepsioni ishin dy-tre veta dhe askush tjetër rreth e rrotull. Ishte një orë qetësie. Unë gjendesha në atë hotel, në Monako, për të marrë pjesë në të njëjtën mbledhje, ku kishte qenë edhe Presidenti i Sllovenisë. Siç do të më tregonte pas pak, vajza me qafën e gjatë dhe gjinjtë e rrumbullakët, deri një çast më parë kishte qenë pjesë e atij grupi njerëzish të rëndësishëm në pritje të ashensorit. Por mua ajo nuk më kishte rënë në sy as kur ishte bashkë me ta e as kur ishte shkëputur prej tyre. Domethënë se vajza me qafën e gjatë e gjinjtë e rrumbullakët nuk kishte asnjë lidhje me shkrimtarin e madh finlandez, rrjedhimisht as me eprorin tim e me sherrin e tij të zhurmsëm. E kisha aq të rrënjosur në tru përkatësinë finlandeze të asaj femre, sa m'u desh një çast të mësohesha me ndryshimin. Ishte sllovene, pra, ajo që kishte përshkuar hollin e hotelit për t'u afruar te qoshja, ku kisha zënë vend unë. Afërmendsh që ajo do të kishte diçka të pazakonshme për të më thënë. Në vazhdim, ajo më ishte drejtuar me mirësjellje, duke përmendur madje edhe kartëvizitën për t'i dhënë kështu takimit qysh në fillim - nëse do të ishte e dëshirueshme nga ana ime, kuptohet - një hije zyrtare. Ndërsa unë e kisha sorollatur mendjen nëpër ca rrugë qorre, në pritje të një sherri, të cilin sa ç'nuk e doja, aq edhe e kërkoja e që, shprehur për analogji me gjuhën e asaj femre të panjohur, duhet të ketë qenë hiç gjë tjetër veç iluzioni, të cilin unë vetë ia kisha sajuar vetes dreqi e di përse, prej një copë here të mirë. Kisha ndjesinë e humbjes së një kohe të çmueshme për shkak të atij iluzioni, sado që nuk e dija për çfarë tjetër më të mirë mund të më kishte shërbyer ajo kohë. Për sa i përket realitetit të asaj femre, unë kisha vëzhguar, edhe pse pa asnjë prapamendim, kryesisht qafën e saj të gjatë dhe gjinjtë e rrumbullakët, ku më besohej tashmë se ishte burimi i aromës turbulluese, që ajo shpërndante përreth. A thua se kisha zënë vend në kolltukun e hollit të atij hoteli luksoz për të gjuajtur ndonjë femër të rastësishme. Më erdhi sakaq turp nga vetja dhe kërceva në këmbë si i zënë në faj.

- Më falni! - thashë dhe u vura në pritje siç më takonte. Duhet të jem skuqur pak.

Tashmë, që e dija se edhe ajo ishte pjesëmarrëse e mbledhjes së madhe, i thashë vetes, i bindur, se do të jem njohur me të diku në ndonjë mbledhje tjetër të këtij lloji. Nuk mund të ishte e kotë gjithë ajo siguri nga ana e saj qysh në fjalën e parë: “Ju duhet të më njihni”. Nuk kisha në kujtesë megjithatë asgjë prej saj. Gjëra që ndodhin jo dhe aq rrallë në mjediset e diplomatëve e që zakonisht kapërcehen lehtë, me mirëkuptimin e të gjitha palëve. Ai që mban mend, gjen mënyrën t’i përmendë - jo si qortim - tjetrit dy a tri hollësi nga takimi i tyre i mëparshëm dhe gjithçka sqarohet pa qenë nevoja për mbetje qejfi e shfajësime të zgjatura. Do të më dukej gjithsesi e pamundshme që, në një herë të mëparshme, qoftë edhe të largët në kohë, shqisat e mia të mos e kenë pikasur atë avullin e padukshëm, me të cilin trupi i saj pohonte përreth feminitetin e vet. Nuk do e kisha harruar. Ose në shqisat e mia të nuhatjes, si mashkull, kishte ndodhur një dëmtim i rëndë.

Isha i tëri i përfshirë në pritjen që më takonte, sipas kodit të mirësjelljes: drejt në këmbë dhe me këmbët e bashkuara te thembrat për ta tendosur trupin, përballë saj, gati për t’u përkulur t’i puth dorën, pa u merakosur për pasojat deformuese, që do të kish në perceptimin tim për të kjo përkulje - gjithnjë sipas përfundimeve të nxjerra nga grupi ruso-holandezo-peruan i psikologëve, fitues së fundmi i Çmimit “IgNobel”, - deformime për të cilat vetë kjo femër sapo më kishte shprehur bindjen e vet se do të jenë shumë të dobishme për njeriun e sotëm dhe atë të nesërm në procesin e tij të njohjes së vetvetes. Unë isha në këtë rast njeriu i sotëm, plot vullnet të mirë për të njohur veten. Gatishmëria për t’u përkulur t’i puth dorën, - me kusht që ajo të më zgjaste dorën- pa u merakosur për pasojat deformuese që do të kishte në perceptimin tim për të kjo përkulje, kjo gatishmëri, pra, do të duhej të dëshmonte mirëfilli përparimin tim pikërisht në njohjen e vetvetes. Unë po filloja të isha krenar për këtë përparim, ani pse kjo femër nuk po e vinte fare re. Ose hiqej mjeshtërisht sikur nuk po e vinte re. Unë nuk zotëroja më asnjë mjet tjetër për t’i shprehur asaj përjetimin e thellë të fajit, ku e kisha zënë më në fund veten. Kisha harxhuar gjithë gjestikulimin e trupit (hovja nga kolltuku drejt e në këmbë, i

pickuar në vend të keq, siç është i keq, më i keqi madje, vendi ku pickon turpi), kisha harxhuar fjalën e përshtatshme (“Më falni!” shqiptuar me një zë të ndrojtur prej të munduri), kisha harxhuar edhe vështrimin (nuk më duhej doemos pasqyra për të ditur si ishin lëngëzuar e vakur sytë e mi të ngulur mbi të). Shto këtu madje edhe një përskuqje të lehtë, që më kishte rrëshqitur nëpër mollëzat e faqeve, gjë e skajshme për një burrë në moshën time dhe me përvojën time. I mbetej asaj ta kuptonte drejt e ta përdorte me vend pushtetin që kishte fituar pikërisht në sajë të vetëdijes së sinqertë të fajit nga ana ime. Një vetëdije e tillë është tipar vetëm i njeriut të pajisur me guximin, që jep njohja e vetes.

Por ajo rrinte si e ngrirë përballë meje, me buzët e puthitura, të cilat, edhe të puthitura tregoheshin mishnore, me një vështrim shpues ngulur në sytë e mi. Në fytyrë i kishte rënë një si ftohtësi e mermertë, që nuk e mbyste dot megjithatë erëzimin e parfumit të saj, ama e bënte të paqenë atë avullin e padukshëm, që kishte lëshuar qysh në krye të herës trupi i saj për të pohuar praninë e vet femërore. As qerpikët nuk i lëviznin. Nuk më kishte lënë hapur as edhe një dritare të vogël fare.

- Më falni! - përsërita në një përpjekje të fundit për të mos u dorëzuar, që do të thotë për të mos e braktisur bisedën.

- Nuk ka asnjë rëndësi nëse ju fal apo s’ju fal unë, - foli ajo më në fund. Unë e dëgjova qartë, e megjithatë kisha përshtypjen se buzët e saj kishin vazhduar të qëndronin të puthitura, ashtu siç edhe sytë nuk kishin lëvizur.

Unë do të kisha dashur krejt sinqerisht t’i kujtoja se falja e saj kishte tashmë shumë rëndësi për mua. Por mblodha supet, i pushtuar sakaq nga një ndjesi kotësie. Hodha sytë nga dera e ashensorit me një shpresë të ngordhur se andej do të dilte eprori im, duke më dhënë kështu arsyen e nevojshme për t’u larguar. Ndjeja në rritje një pafuqi të çuditshme për t’u zemëruar me atë femër, sado që një përfytyrim i shpejtë i vetes në atë çast përpara saj duhej të më kishte lënë në vetëdije një shije fort të hidhur. Një fotografi e imja ashtu, me supet e mbledhura dhe sytë e vakur, do të jepte një pamje shumë qyqare, të tillë që nuk përputhej gjëkund me njohjen që kishin prej shumë vitesh njerëzit për mua. Të paktën me aq sa dija unë për veten. Ajo

lëvizi ngadalë njëren këmbë pak përpara si njeriu që kërkon të çmiphet disi dhe, fare papritur, më bëri shenjë me dorë nga kolltuku.

- Ulemi! - tha me një ton urdhërues. - Kemi gjëra për të folur.

Unë iu binda dhe zura vendin që kisha pasur. Ajo shkoi përballë. Paralajmërimi i saj gjithsesi i rreptë se kishim gjëra për të folur e që do të duhej të shënonte haptas një teprim nga ana e saj në përdorimin e pushtetit, të cilin unë vetë, me dashje ose pa dashje, ia kisha dhënë, nuk më zgjoi megjithatë asnjë nerv vetëmbrojtjeje dhe as nuk më shtyu drejt ndonjë hamendjeje rreth gjërave, për të cilat do të flisnim. Nuk prisja më asgjë nga ajo bisedë. Boll që ajo femër nuk kishte të bënte me shkrimtarin finlandez! Ai, bashkë me dy ndihmësit e vet ballkanikë, ishte zhdukur nga hollit i hotelit. Me siguri që ishte mbyllur në dhomën e tij për të ndryshuar skenarin e romanit të vet të ardhshëm, ku eprori im do të shtohet ndoshta si personazh për t'u vënë përballë me arkitektin Gjergj Shkodra, në një përplasje simbolike, ku ekzotizmi dhe arkaizmi shqiptar do të preknin kulmin e groteskut, krejt në përputhje me stilin karikatural, që shkrimtari kishte zgjedhur paraprakisht për ta paraqitur në romanin e vet historinë e re shqiptare. Kacafytja rastësisht në hollin e një hoteli luksoz në Monako e njërit nga udhëheqësit më të lartë politikë të Shqipërisë postkomuniste me arkitektin Gjergj Shkodra - përfaqësues tipik, me projektin e tij, i kapitalizmit të ri në këtë vend - ishte një vlerë e re e shtuar për subjektin. Për sa më përkiste mua, kuptova se një frikë instinktive më kishte shtyrë drejt hamendjes se ajo femër ishte një asistente e shkrimtarit finlandez. Për pasojë, një bisedë e çfarëdoshme me të do të shënonte edhe përfshirjen time të pashmangshme në meselenë e romanit të ardhshëm finlandez. Kuptova gjithashtu se pikërisht çlirimi nga ajo frikë më bënte tashmë kaq të durueshëm, domethënë të bindur ndaj anëtares së kabinetit të Presidentit të Sllovenisë. Në atë hallakatje të trurit, nuk ishte fare çudi pse unë mendova se këndet e kolltukëve nëpër hollet e hoteleve nuk janë bërë për biseda intime. I pushtuar nga ndjesia e kotësisë, por edhe i ndihmuar nga ftohtësia, që vazhdonte t'i mbante të ngrira tiparet e fytyrës së sllovenes, duke asgjësuar si me magji atë avullin e padukshëm që kishte lëshuar deri pak më parë në ajër trupi i saj femëror, unë po ndjehesha si

i çliruar nga pushteti i saj. Të paktën nuk e kisha më atë ndjesinë e të zënit në faj.

Ajo nuk po niste të fliste për gjërat, për të cilat më kishte paralajmëruar, duke më nxitur kështu me heshtjen e vet pak e nga pak të shihja tek ajo diçka më shumë se buzët e puthitura dhe sytë e palëvizshëm. Jo vetëm qafën e kishte të gjatë, por edhe këmbët. Ulur, gjinjtë e saj ngriheshin më lart dhe sikur merrnin një rrumbullakësi të re mbështetur mbi dy kupat e gjunjëve të mbledhur e të ngritur për shkak të tryezës së ulët që na ndante. Ajo rrinte në cep të kolltukut, sikur zgjatej drejt meje. Bëra kujdes të mos e çoj me tepri vështrimin te gjinjtë e saj. I bindur për të mos folur unë i pari, po e hetoja trupin e saj me njëfarë qetësie, të cilën do e kisha quajtur shpërfillje sikur në sjelljen time të mos ishte kjo hollësi: nuk doja ta shihja në sy. Druhesha se sytë e saj vazhdonin të ishin të palëvizshëm. Një palë sy të mëdhenj, të mbushur me një përndritje midis të gjelbrës e të kaltrës. Zbutej drita e pasdites aty. Ose ndoshta, do thënë më mirë se drita e fortë e pasdites mesdhetare zbehej aty krejt si një shpirt i trembur për shkak të mpirjes që kishte pushtuar ata sy siç unë i kisha vënë re pak më parë. Nuk kishte vend më për kureshtje nga ana ime kur ishte fjala të vëzhgoja çfarë po ndodhte në sytë e saj tani që ishim ulur. Më mirë të mos e dija.

- Desha vetëm t'ju dëshmoja se edhe sytë e blertë kanë thellësi të mjaftueshme për t'i fshehur trazirat e mëdha të shpirtit, - foli më në fund ajo.

- Urdhëro?

- Po, pra, kështu. Ju keni shkruar se sytë e kaltër dhe ata të blertë nuk kanë thellësinë e mjaftueshme për t'i fshehur trazirat e mëdha të shpirtit. E shikoni që jeni gabuar? - vazhdoi ajo pa më lënë kohë të mblidhja veten. Vështrimi i saj i ngulur mbi mua buronte nga një palë sy prej qelqi pa tejdukshmëri. Ajo iu përgjigj vetë dhe pa vonesë pyetjes së vet: - Doemos që e shihni. - Ajo, plotësisht e sigurtë në ato që po thoshte, kishte shpalosur rreth gojës një buzëqeshje të përmbajtur ngadhënjimtare me çmimin e shkyçjes së buzëve për ta liruar dritën shkumore të detit të vezullonte nëpër dhëmbët e saj të bardhë.

Unë nuk po kuptoja asgjë dhe ia pohova asaj sinqerisht që nuk po e kuptoja, duke u përpjekur madje edhe t'i jap zërit diçka të ngjashme me rreptësinë burrërore. Por pa e shkelur detyrimin e çuditshëm që ndjeja për të qenë me të gjithësi i sjellshëm. I thashë ndërkohë vetes se duhej të largohesha sa nuk ishte ende vonë dhe bëra atë lëvizjen e vockël, që i nevojitet trupit kur përgatitet të ngrihet nga kolltuku. Nuk arrita ta shqiptoj kërkesën për lejë, siç e donte mirësjellja e lartë. Ajo ndërhyri me të njëjtën vendosmëri:

- Kemi kohë të flasim për shumë gjëra. Shefi im e bën gjithmonë një pushim të mirë pasdreke. Të paktën këtë zakon e ka si ballkanik i vërtetë. Me siguri edhe shefi juaj nuk bën përjashtim.

- Për çfarë duhet të flasim? Më thoni, për çfarë duhet të flasim? - Më shumë se pyetje, padashur unë i kisha drejtuar një lutje. Dhe instinktivisht u rehatova sërisht në kolltuk.

- Çfarë keni shkruar të re pas *Boshit*? Nuk kam parë ndonjë përkthim të ri në frëngjisht.

Unë i buzëqesha me një mirënjohje të sinqertë dhe isha gati ta qortoja pse nuk e kishte bërë qysh në fillim bisedën kaq të thjeshtë. Pata sakaq një fërgëllimë në nuhatje. Sikur u zgjua ai avulli i padukshëm i trupit të saj femëror, i cili vepronte si një frymë e brendshme mbi parfumin, që ajo kishte hedhur mbi lëkurë, siç edhe mbi krejt ajrin e kondicionuar të hollit të madh të atij hoteli. Por kjo fërgëllimë u këput kur vështrimi im u ngjit deri te sytë e saj. Aty nuk kishte lëvizur ende asgjë. Ashtu të mëdhenj e të mbushur me një dritë si brumë qelqi midis të gjelbrës e të kaltrës, ata sy kishin sidomos një mungesë kureshtjeje, pa të cilën pyetja e saj, gjithësi rutinore për veshët e një shkrimtari, tingëllonte gati e bezdisshme. Me hov të prerë, nuk pata më dëshirë ta vazhdoj bisedën për shkrimet e mija dhe e pyeta përse nuk shkonte edhe ajo të bënte gjumin e pasdrekes si shefi i saj.

- Jam këshilltare në kabinetin e Presidentit të Sllovenisë, - m'u kthye rreptë. - Jo shoqëruese në dhomën e tij të gjumit. Për kohën e tij të lirë, rruga ime mbaron aty, ku më patë edhe ju: para ashensorit. - Zëri i saj ishte deri në fund i rreptë, por nuk e kishte atë hidhësirën e një sedre femërore të fyer. Nuk ishte e

nevojshme të zgjatesha me shpjegime rreth keqkuptimit që i kisha ngjallur me pyetjen time, e cila edhe mund të merrej si e pavend.

- Nuk ju kam vënë re para derës së ashensorit, sinqerisht. - Nuk po e gënjeja. - Pastaj, ju e dini edhe vetë, në raste të tilla sytë e të vegjëleve mbeten te Presidenti, jo tek ata që e rrethojnë, - shtova si për t'i thënë me një buzëqeshje të lehtë se nuk ishte faji i saj pse nuk më kishte rënë në sy. Ajo duhej të ishte mësuar me përqendrimin e vëmendjes së publikut tek eprori i saj fuqiplotë. Vazhdoja të isha i vendosur të tregohesha me sa mundesha i sjellshëm.

- Në këtë rast dhe pikërisht me ju nuk duhej të ndodhte kështu. - Ajo nuk kishte ndër mend të më linte asnjë dalje, gjë që më nervozoi. Ajo nuk kishte asnjë të drejtë të më fliste ashtu. Bëra përsëri atë lëvizjen e vockël, që i nevojitet trupit për t'u ngritur nga kolltuku, sado që në dhomë nuk ngjitesha dot. Eprori im nuk më kishte caktuar asnjë orë kur mund të dilte dhe isha i detyruar të prisja në holl. Por do të dilja para hotelit, nga ku dukej gjiri i detit i mbushur me jahte të bardha dhe një pjesë e Monakos së vjetër, ku gëlonin turistët edhe pse nuk kishte ardhur ende plotësisht vera. Ishte maj. Nëse më duhej një arsye e mjaftueshme për t'i dhënë duart asaj femre, që po më qepej, e kisha: më pihej duhan. Duke thithur cigaren dhe me pamjen e gjirit të detit, do e kaloja pa e ndjerë kohën në pritje të eprorit tim, i cili edhe do të ishte qetësuar tashmë nga sherri me shkrimtarin finlandez. Por mund të kishte ndodhur edhe e kundërta: atje në dhomë, i vetëm, ai po ripërtypte zemërimin kundër meje, duke u bindur fort e më fort se më kishte takuar mua e vetëm mua si *shkrimtar-ministër* të përballesh me të huajin në atë sherr, që do të thoshte se unë duhej të përgjigjesha dyfish me t'u kthyer në atdhe: përpara atij si vartës për mosbindje ndaj eprorit e përpara kombit si shkrimtar dezertor. Punë e madhe! thashë me vete dhe as nuk u çudita nga më erdhni papritur gjithë kjo mospërfillje, që nuk e kisha pasur kurrë ndaj atij burri, me të cilin më lidhte një miqësi shumë më e gjatë se periudha e bashkëpunimit në politikë. - Ju e kuptoni fare mirë vetë pse nuk duhej të ndodhte pikërisht me ju kështu, - theksoi sllovenia. Kur nuk i dhashë asnjë shenjë mirëkuptimi, shtoi: - Një shkrimtari nuk i shkon të hutohet pas një politikani, kushdo qoftë ai.

- Unë nuk kuptoj asgjë. Dhe as nuk dua ta kuptoj. - E ndjeva se e kisha kapërcyer kufirin e mirësjelljes duke ia prerë ashtu shkurt, por nuk më bëri më përshtypje. Nuk kisha më durim. E pse duhej të tregohesha aq i duruar, në fund të fundit? Do të dilja në oborrin e hotelit të pija një cigare duke parë detin.

Atëherë ajo tha atë fjalinë që më mbajti sërish në vend:

- Ju nuk po mendoni se unë jam e çmendur. Unë nuk mund të jem e çmendur, qoftë edhe për faktin se punoj këshilltare në kabinetin e Presidentit të vendit tim. Nuk do e linte njeri një të çmendur të këshillonte Kryetarin e Shtetit. Ju kaq gjë e dini më mirë se unë, apo jo?

Më erdhi për një çast ta pyesja se për çfarë e këshillonte ajo Kryetarin e Shtetit të vet, por u përmbajta. Pyetja ime do të tingëllonte tepër përçmuese, dhe do të ishte pa dobi të sherratosesha me një femër sidomos kur ajo ishte lënduar në sedër. Në mos, me një pyetje te tillë do i jepja asaj shkas të më rrëfente për punën e vet si këshilltare e Presidentit, gjë që përsëri nuk më thoshte asgjë prej gjëje.

- Nuk mendova se jeni e çmendur, - iu përgjigja. - Thjesht, nuk ju kuptoj dhe as që më duhet t'ju kuptoj.

- Nuk më thatë, çfarë keni shkruar pas *Boshit*?

- Nuk kam shkruar asgjë.

- Ja, pra, këtu është e keqja, që ju pengon të më kuptoni. Po ç'keni bërë gjithë këto vite, i dashur Zotëri?

- Zonjë!

- Zonjushë, - më ndërpreu ajo.

- Zonjushë, gjithë këto vite unë jam marrë me politikë, me diplomaci, me një fjalë, kam bërë detyrën në shërbim të vendit tim me aq sa kam mundur.

- Aha, e qartë. Keni zbuluar lezetin e pushtetit dhe shfajësoheni para vetes me një nga këto parimet e mëdha, që mbushin stendat e pluhurosura të muzeve të Historisë Kombëtare gjithandej nëpër vendet tona ish-komuniste. Thënë ndryshe, në një gjuhë që do të duhej të ishte gjuha juaj, jeni rehatuar në radhët e jeniçerëve të një kohe të premtuar, pa e vrarë mendjen çfarë do të duhej të priste nga ju sot kjo kohë dikur e premtuar.

Nuk e di pse nuk u nxita për ta kundërshtuar. I thashë vetëm dhe pa ndonjë rreptësi të madhe, se ligjërata e saj kishte një cinizëm të tepruar, që nuk më pëlqente. Ajo m'u përgjigj me një tundje të kokës, që nuk ishte as miratim as mohim. Por kishte aty gjithsesi një shenjë të parë gjallërie. Sytë e saj më në fund lëvizën. Ndoshta kështu do të merreshim më lehtë vesh. Për çfarë do të merremi vesh? pyeta sakaq veten me shpresën e një vale zemërimi. Por nuk arrita të zemërohem. Ndërkohë ajo foli:

- Cinike? "Jeniçerët e një kohe të premtuar" janë fjalët tuaja, Zotëri. Kapitulli i parë i tablosë së pestë të *Boshit*. Ju as nuk e mbakeni mend kë keni përcaktuar aty si jeniçerët e një kohe të premtuar. Dua të them, për çfarë njerëzish e kishit fjalën. - Ajo ndaloi sikur do të mbushej me frymë, më vështroi drejt në sy me një shprehje hundëpërpjetë dhe vazhdoi me një ton të ndryshuar: - Me sa kuptoj, ka ndodhur diçka e rëndë me ju dhe më vjen sinqerisht shumë keq për ju. Në fakt, a jeni ju vërtet Besnik Mustafaj, apo jam unë e gabuar?

Mënyra si më kishte përmendur romanin e shkruar më shumë se dhjetë vjet më parë, më kishte lënë pa gojë. Kurrë nuk më kishte hutuar kështu takimi me një lexues të veprës time letrare. Nuk dija më as si të sillesha me atë femër, e cila kishte ditur të fitonte mbi mua një të drejtë, që nuk do të duhej ta kishte askush: të më përçmonte sy për sy. Po ndodhte me siguri diçka e rëndë me mua, ndoshta jo në kuptimin që kishte parasysh kjo e panjohur tek më përçmonte.

- Nuk jeni gabuar. - Do të kisha shtuar edhe diçka, qoftë edhe nga nevoja për ta fshehur hutimin, por ajo më ndërpreu:

- E kam fjalën për shkrimtarin, autorin e *Boshit*.

- Unë e kam shkruar, po, po, unë e kam shkruar.

- Ju paskeni ndjekur këto vite rrugën e kundërt me *Agron H*, - vazhdoi ajo me një siguri në vete, ku theksohej edhe më fort një keqardhje për rrugën, nëpër të cilën kishte rrjedhur jeta ime gjithë këto vite. - Me mundim të madh, do thënë me plot gojën heroikisht, Agron H. iku nga radhët e jeniçerëve të kohës së

premtuar, ku fati, pa e pyetur, e solli të jetonte. Ju vetë, që edhe kishit mundësi të zgjidhnit, u kthyet me vullnetin tuaj plotësisht të lirë në sojin e gjithëkohshëm të jeniçerëve. Dhe u përshtatët aq mirë, sa hoqët dorë pa dhimbje edhe nga shkrimi. Madje, si jeniçer i vërtetë, pastruat edhe kujtesën nga gjurmët e mëparshme, ato që doemos do t'ju pengonin të jeni siç po më shfaqeni mua tani.

Një shqisë e padallueshme më paralajmëroi se diku - diku ajo kishte të drejtë. Po në çfarë kishte të drejtë? Afërmendsh që nuk do të pranoja se kisha hequr dorë nga shkrimi. Një vendim i tillë as nuk më kishte shkuar nëpër mend dhe nuk do të më shkonte kurrë. Në gjyqet, që i bëja herë pas here vetes, arrija në përfundimin se gjithë problemi im në këtë pikë ishte të organizohesha më mirë, për t'i lënë kohën e vet edhe shkrimit, gjë që do e bëja patjetër dhe shumë shpejt. Do të më ndihmonte doemos edhe përvoja në zotërimin e dosjeve të punës për t'u organizuar më mirë në gjithë përditshmërinë time. Kaq të thjeshta ishin gjërat! Kisha plot bërthama historish nëpër fletoret e mia të vjetra e të reja, që prisnin prej vitesh t'i shkruaja. Do i shkruaja. Nuk kishte ndryshuar asgjë në vendosmërinë time për ta shkruar veprën time letrare, të nisur vite më parë se të më joshte politika. Ajo femër gabohej, padyshim që gabohej, kur thoshte se përshtatja me jetën e re të pushtetit më kishte ngopur aq sa të hiqja dorë pa dhimbje nga shkrimi. Ose më provokonte. Pse duhej të më provokonte? Pa asnjë arsye paraprake, gjatë gjithë këtyre viteve në politikë, më kishte shoqëruar një frikë e fshehtë se një ditë do të bëhesha paranojak dhe kisha vigjiluar me një vullnet të hekurt ndaj çdo shenje të dyshimtë siç veprova edhe në këtë rast duke ia prerë shkurt vetes hamendjen se e gjithë kjo mesele mund edhe të ishte një provokim. Pyetja e shpejtë se përse duhej të më provokonte kjo femër e panjohur apo dikush tjetër pas saj, ishte mirëfilli mohim i një mundësie të tillë, sado që mbetesh vërtet i paqartë lidhur me gjurmët, nga të cilat unë e kisha pastruar kujtesën sipas saj. Fjala do të ishte për ca gjurmë të mistershme, të cilat shprehnin mënyrën time të jetesës dikur. Sikur të kishin mbijetuar këto gjurmë në kujtesën time, do të më kishin penguar të isha ky që po i shfaqesha asaj tani. Mora guximin t'i kërkoja një shpjegim të tërthortë:

- Pse, si po ju shfaqem juve tani?

- Keni gjithë kohën që kujdeseni për t'u treguar sa më i sjellshëm me mua, pa e vrarë hiç fare mendjen se ç'më shtyn mua të vij drejt jush...

E ndërpreva.

- Ua thashë qartë, më duket. As që më duhet të kuptoj ç'ju shtyn juve të vini drejt meje. Nuk dua ta kuptoj. U morëm vesh?

- Siç po shoh, për ju ka rëndësi tashmë vetëm të jeni në paqe me veten dhe për këtë ju mjafton të tregoheni thellësisht i sjellshëm me mua. Dijeni se ia keni arritur qëllimit! -vazhdoi ajo si të mos më kishte dëgjuar. - Agron H. kishte një mirësjellje ndaj mjedisit ku jetonte e që, në të vërtetë, ishte nënshtrimi ndaj sistemit, por që më së paku merrte një shpërblim për egon e tij. Ai fitonte kështu mirënjohjen e babait të vet. Po ju, mirënjohjen e kujt kërkonit? Dua të them, ju, me një mirësjellje të tillë kaq të sheqerosur ndaj meje, cilën ego doni të kënaqni? Sigurisht jo egon e shkrimtarit Besnik Mustafaj. Të paktën jo atë ego, që ai duhet të ketë pasur kur shkruante *Boshin*.

Unë as që e mora me mend ku deshi të dilte kur më tha se këto vite kisha ndjekur rrugën e kundërt me Agron H. Në këtë fundviti, pasi kaloi edhe 21 dhjetori 2012 pa sjellë mbi botën tonë kiametin e parathënë në kalendarin e fiseve indiane maja, tek orvatem të gjej fjalët e përshtatshme për ta shkruar këtë histori, kam qetësinë e mjaftueshme të përfytyroj sa shpartallues do të kishte qenë përçmimi i saj sikur ta kisha pyetur se kush ishte ky Agron H., me të cilin po më krahasonte. Mund edhe ta kisha pyetur, aq të mpirë e ndjeja trurin për shkak të hutimit - nuk isha mësuar të më drejtohej ndokush me një ton të tillë, - por edhe për shkak të një euforie të turbullt, që ajo kishte zgjuar papritmas brenda egos time duke më dhënë të kuptoj se ishte një adhuruese e romanit tim. Gjëja e fundit që do të më vinte ndërmend në ato rrethana, ishte zemërimi, për t'ia prerë shkurt fjalën, siç do të kisha vepruar me cilindo të panjohur tjetër, që do të guxonte të ma hidhte ashtu në koshin e plehrave si pa vlerë vetë kuptimin, që i kisha dhënë unë jetës time gjatë këtyre viteve të lirisë. Pikërisht kjo eufori, që po e pushtonte egon e shkrimtarit si një mjegull që pushton një luginë, më hoqi dhe

fijen e fundit të dyshimit se dikush ma kishte kurdisur këtë mesele të çuditshme për t'i dhënë një goditje karrierës time. Mblodha forcat për ta kapur disi fillin e bisedës, të cilën, qoftë edhe për arsye të përvojës, më takonte ta zotëroja. Por ajo nuk më la kohë.

- Jam marrë me politikë, me diplomaci, me një fjalë, i kam shërbyer vendit tim, - zuri të përsëriste gjithë qesëndi fjalët e mia.

Sedra ime nuk u ndje mirë. Isha përsëri i detyruar të mbrohsha.

- Po, Zonjushë e dashur, këto kam bërë dhe e kam për nder, - ia ktheva rreptë.

Ajo as që m'i hodhi sytë.

- Politikë... diplomaci... shërbyer... vendit tim, - përsëriste ajo duke mbllaçitur zhurmshëm fjalët. Do të kisha thënë se nuk më drejtohej mua.

Në fakt, ajo nuk i drejtohej më askujt. Nuk fliste madje as për vete. Unë pata kështu pak liri të mendoja përtej euforisë së turbullt, që ajo kishte zgjuar papritmas brenda egos time të shkrimtarit duke më dhënë të kuptoj se ishte një adhuruese e romanit tim. Kjo ego e shkrimtarit, e topitur nga gjumi i gjatë, do e kishte detyrimisht të shkurtër flakën e euforisë. Nderi ma donte të largohesha menjëherë nga ajo tryezë dhe bëra për të tretën herë atë lëvizjen e vockël të trupit që përgatitet të ngrihet nga kolltuku. Kisha përshtypjen se ajo nuk e kishte më mendjen tek unë. Do të largohesha pa e përhëndetur, duke i treguar me një gjest të tillë se nuk ishte e vërtetë që mirësjelljen e kisha merakun më të madh. Dija fare mirë të isha shumë i pasjellshëm. Domethënë, që nuk jetoja për t'u pëlqyer pa kushte nga të gjithë, por për të qenë në paqe me veten.

Trupi ishte bërë gati për t'u ngritur dhe po priste vetëm urdhrin e fundit të drejtohej, një urdhër që duhej të vinte nuk e di nga cila pjesë e trurit tim, por që nuk po vinte. Unë po qëndroja thuasje pezull mbi kolltuk, në një pritje pa kuptim, ndërsa ajo përsëriste si në jerm: politikë... diplomaci... shërbyer... vendit tim. Edhe unë po ashtu e dëgjoja, përhumbtazi, gati-gati pa u kujtuar se ajo po përqueshte pikërisht përgjigjen time ndaj pyetjes së saj, se me çfarë isha marrë gjithë këto vite pas shkrimit të *Boshit*.

- **K**am kaq kohë që kërkoj rastin të takohem me ju dhe ja ku më erdhi, këtu, ku s'e prisja. - Mu përballë meje, në një qëndrim të tendosur me kujdes, kishte mbirë një femër. Them "kishte mbirë", pasi nuk e kisha vënë re fare të më afrohej, ani pse e kisha pasur gjithë kohën përballë. Në të vërtetë, unë kisha një grimë herë që ndjeja në ajër një parfum - një aromë e përzier frutash, - dhe bashkë me të ai avulli i padukshëm, që pohon praninë e një trupi femëror në lulëzim diku rrotull, por as që kisha pasur kureshtjen më të vogël të gjeja me sy burimin nga vinte. Pas asaj përplasjes së pakëndshme midis eprorit tim dhe shkrimtarit finlandez aty në holl, nuk kisha më dëshirë tjetër veç të harroheshja ca çaste, mundësisht me kokën krejt të zbrazët. Nuk doja të mendoja asgjë. Ky ishte ushtrimi im për t'u shkëputur nga ngjarjet bezdisëse, një ushtrim i kalitur në vite, gjatë të cilit unë me siguri ngjaja pak si somnambul. Zakonisht tërhiqesha mënjane në raste të tilla pikërisht për të mos u lënë të tjerëve përshtypjen se po flija në këmbë, me sy hapur. Me sa duket asaj pasditeje maji nuk e kisha dhe aq pamjen e njeriut që po fle me sy hapur. Të paktën jo për sa kishte vënë re ajo femër, e cila kishte përshkuar nuk e di se si hollin e gjerë të hotelit për t'u afruar te qoshja, ku kisha zënë vend unë dhe po më thoshte me një zë pak të ngjirur (jo se e vura re në çast si tingëlloi zëri i saj,

por tani, tek shkruaj historinë, dhe di si rrodhën ngjarjet në vazhdim midis nesh, përfytyrimi i fytit të saj të tharë nga dyndja e emocioneve më çon te bindja se ajo zërin e kishte doemos pak të ngjirur) po më thoshte, pra, me një zë pak të ngjirur se kishte kaq kohë që kërkonte rastin të takohej me mua dhe se ky rast i erdhi këtu, ku nuk e priste.

Unë duhet ta kem ngritur vështrimin drejt saj, qoftë edhe pa një qëllim të caktuar dhe i kam dhënë megjithatë kohë vetes të vëzhgoj mirë qëndrimin e saj të tendosur dhe ku, dashje pa dashjen e saj, dilte veçanërisht në pah qafa e zgjatur dhe gjoksi i kërcyer aq sa duhej për të theksuar lehtë rrumbullakësinë e gjinjve. Ende nuk ishte bërë ndonjë lidhje në kokën time midis atij avullit të padukshëm, shpërndarë si dielli në ajër përmes parfumit për të pohuar një prani femërore mbresëlënëse diku rrotull dhe asaj femrës mu përballë meje, e cila ndjente fythin t'i thahej nga dyndja e emocioneve pse po takohej me mua. Anova pak kokën majtas për të ndjekur me vështrim grumbullin e vogël të burrave që diç bisedonin pa ndonjë gjallëri të veçantë para derës së ashensorit. Midis tyre kisha dalluar siluetën e Presidentit të Sllovenisë. Ajo vuri dy duart në tëmthat e mi dhe më drejtoi kokën.

- Jo kështu, - tha dhe qeshi.

Qesha edhe unë duke kujtuar ekipin e psikologëve ruso-peruano-holandez. Ndoshta edhe ajo ishte në dijeni të përfundimeve, ku kishin arritur ata psikologë të shquar, për të cilat edhe ishin nderuar jo dokudo, por brenda rrethores së Universitetit të Harvardit me Çmimin Ndërkombëtar "IgNobel" në edicionin e tij të fundit. Sipas tyre, kur përkulesh majtas, Kulla Eiffel ngjan më e vogël. Duke më parë mua të përkuqja kokën majtas, ajo ishte alarmuar në instinktin e saj femëror. Sidomos në këtë takim të parë, kaq të dëshiruar, ajo nuk do të donte kurrsesi të më ngjante sadopak më e vogël nga ç'ishte apo edhe e shtrembëruar sadopak. Ky ishte mendimi i parë pak a shumë i kthjellët që më kaloi nëpër kokë dhe pati rëndësi të paktën për ta zgjuar vëmendjen time. Ende i kisha të ngrohta mbi lëkurë prekjet e dy pëllëmbëve të saj në tëmthat e mi, që do të thoshte se ajo e kishte marrë fytyrën time midis pëllëmbëve e shtyrë

nga diçka krejt pa lidhje me pandehmën time për të drejtuar kokën time të anuar majtas. Madje, në mënyrën se si e kishte marrë kokën time të zënë në befasi midis pëllëmbëve të veta, ajo kishte treguar një shpengim, që mund të merrej pa u tepruar si intimitet midis nesh nga grupi i vogël presidencial slloven në pritje të ashensorit, pjesë e të cilit, siç do të mësoja pak më vonë prej gojës së saj, kishte qenë edhe ajo vetë deri një çast më parë. Mua ajo nuk më kishte rënë në sy as kur ishte midis kolegëve të vet e as kur ishte shkëputur prej tyre për t'u drejtuar nga unë. Gjithë kohën unë aty kisha parë vetëm Presidentin, të rrethuar nga një grusht burrash të veshur me kostume të errëta dhe kravata të kuqe apo ngjyra të përafërta me të kuqen, të cilat rrinin si të ngjitura pas këmishëve të bardha.

Në të vërtetë, vështrimi im ishte ndalur aty jo pse kishte pikasur një president, por sepse në hollin e hotelit nuk kishte gjë tjetër më të dukshme për t'u hutuar për pak minuta. Do të ndjehesha keq në qoftë se Presidenti i Sllovenisë apo ndonjëri nga bashkëpunëtorët e tij e kishin vënë re lehtësinë, me të cilën unë lejoja një femër të re të merrte kokën time midis pëllëmbëve të veta të buta në hollin e një hoteli të madh. Ashensori mbërriti ndërkohë, dera e tij u çel me një kërkëllimë të lehtë dhe Presidenti i Sllovenisë bashkë shpurën e tij u shty brenda. I brejtur nga turpi se Presidenti i Sllovenisë me të vetët do të ishin tashmë duke më marrë nëpër gojë, unë do e kisha ndjekur me të njëjtën kotësi deri në fund edhe ndizeshuarjen e dritave të vogla, që shënonin numrat e kateve të përshkuara prej ashensorit, sikur të mos e humbte durimin pikërisht shkaktarja e turbullimit tim.

- Unë për ju erdha këtu, -tha. - Ku e keni mendjen ?

- Për mua? Ku keni ardhur për mua, Zonjë? - Besova se më erdhi në shteg për t'i treguar vendin. Do ta bëja ta mbante mend gjithë jetën këtë takim, të cilin, siç ajo ma tha vetë në krye të herës, e kishte kërkuar prej kaq kohësh.

- Zonjushë, - ndërhyri ajo shpejt e shpejt.

-Ku keni ardhur për mua, ju, Zonjushë?- përsërita, por tashmë pa hakërrimën e parë. Instinktivisht sytë më ishin ndalur ndërkohë te gjinjtë e saj të rrumbullakët.

-Ore, çka ky kështu? - foli ajo duke ngritur sytë lart sikur i ankohej qiellit. Pastaj e uli vështrimin drejt meje, që nuk kisha lëvizur nga kolltuku. - Për ju, pra, erdha këtu, ku jam tani. Për kë tjetër do të guxoja të lija Presidentin e Republikës bashkë me gjithë kabinetin e tij?

- Cilin president? Ç'lidhje kam unë me presidentin?

- Presidentin tim, sigurisht. Ju e patë mirë. Na i kishit ngulur sytë. Unë punoj për të, që ta dini. Jam këshilltare në kabinetin e tij.

- Ah, po, Presidenti i Sllovenisë. Atë po, sigurisht që e vura re, aty, para ashensorit, me disa njerëz. Por juve jo, as që ju kam vënë re. Pse, me ta ishit ju?

-Ndoshta ju bezdis. Më thoni të largohem nëse po ju bezdis!
- Ajo kishte papritur zërin e një të lënduare.

Unë nuk iu përgjigja. Më takonte mua të sillsha si i lënduar. Ajo kishte kapërcyer disa caqe, të cilat unë e kisha edhe për detyrë qytetare t'ia kujtoja, madje në një mënyrë, që ajo të mos e harronte më kurrë. Po përpiqesha të zemërohesha. Nuk doja që vështrimet tona të kryqëzoheshin dhe nuk dija ku t'i ndaloja sytë, të cilët më sillleshin si me magji drejt gjinjve të saj të rrumbullakët.

- Bëjmë një marrëveshje?- e theu ajo heshtjen.

- Nuk shoh ç'marrëveshje mund të bëjmë bashkë, - iu përgjigja me sa munda ftohtë. Vazhdoja përpjekjet për t'u zemëruar me të. Por më pengonte kujtimi i të qeshurës time të pavullnetshme kur ajo kishte marrë kokën time midis duarve të veta për ta drejtuar vështrimin tim andej nga dëshironte, me një lirshmëri, që nuk do të duhej ta kishte. Jo kështu, më kishte thënë. Dhe unë vetëm kisha qeshur, gjë që ajo me të drejtë e kishte marrë si miratim nga ana ime për ndërhyrjen e saj, duke i çelur kështu rrugën një keqkuptimi, që vazhdonte. Më e thjeshta për t'i dhënë fund këtij keqkuptimi sa gjërat nuk ishin mahisur ende, ishte që unë të ngrihesha. Të largohesha me hapat e mi të rëndë prej burri të ngarkuar në përgjithësi me mendime të mëdha, por edhe konkretisht i lodhur nga tensioni i mbledhjes së gjatë e fort të rëndësishme të paradites dhe po aq i plogështuar natyrshëm

nga ngrënia e pirja ndoshta pak me tepri gjatë një dreke, ku gjithçka kishte qenë e përsosur në sajë të Sekretariatit të Bashkimit për Mesdheun, që ftonte. Kjo ishte organizata më e re ndërkombëtare dhe administrata e saj ishte shqyer katërsht për t'u lënë deri në hollësi përshtypje të mirë vendimmarrësve më të pushtetshëm të këtij Bashkimi. Si të mos mjaftonin të gjitha këto, duhej të mbaja tashmë edhe brengën e sherrit të eprorit tim me shkrimtarin e madh finlandez. Në afat të gjatë, përplasje të tilla e nxjerrin pashmangshëm humbës politikanin. E drejta e bashkë me të e vërteta si të tilla avullojnë dhe mbetet si dëshmi për Historinë, pa mundësi ballafaqimi, vetëm përshkrimi, që shkrimtari do i bënte ngjarjes, kuptohet, sipas ëndjes së vet. Eprori im e kishte fshehur gjithmonë keq ëndrrën e tij për ta detyruar Historinë t'i ngrinte nesër një monument madhështor. Shkrimtari mund t'i bënte atë që nuk do e linte të qetë as në varr: t'u mbushte mendjen ca njerëzve, që nuk kishin lindur ende, të pështynin mbi monumentin e tij. Unë isha i sigurtë se eprori im, me t'u gjendur vetëm në dhomë, ishte penduar për sherrin me shkrimtarin finlandez. Por sedra e njeriut të pagabueshëm nuk e lejonte të kërkonte falje. Për pasojë, unë i kisha të gjitha arsyet ta përjetoja nga pikëpamja ime vuajtjen e tij të thellë për dëmtimin e ëndrrës së tij më të shenjtë.

Gjërat mund të kishin rrjedhur krejt ndryshe sikur kjo femër, e mbirë para meje si djall, të kishte qenë ndonjëra nga asistentet e shkrimtarit finlandez. Ajo ishte vetëm një këshilltare e presidentit të Sllovenisë, sado që e çuditshme si këshilltare, me të cilën nuk më lidhte asgjë. Unë duhej të ngrihesha sa nuk ishte vonë nga ky kolltuk, ku vazhdoja të qëndroja si shushaq, nuk e di qysh kur, duke i dhënë kësaj femre të panjohur një kohë të pashtershme të vëzhgonte kripin e rralluar e të përkequr mbi tepelekun tim. Të ngrihesha pa i kërkuar ndonjë leje, pa i dhënë ndonjë shpjegim, madje edhe pa e përshëndetur sa për adet me një përkulje të lehtë të kokës. Të largohesha me hapin tim të rënduar drejt daljes, pa e kthyer kokën pas, për ta parë kush kishte dëshirë ta shihte (kamerat vrojtuese nuk duhej të mungonin në hollin e një hoteli si ky) se unë nuk kisha asnjë lidhje me atë femër. Gërvishtja e një kureshtjeje ende të

papranuar nga logjika ime po më mbante megjithatë ngjitur pas ndenjësës. Çfarë marrëveshjeje kërkonte të bënte me mua ajo femër, të cilës unë nuk i dija as emrin?

Por unë e dija se ajo ishte këshilltare në kabinetin e Presidentit të Sllovenisë. Pavarësisht kapërcimit të procedurave, mua, me funksionet që mbaja, nuk më lejohej të shpërfillja faktin se këshilltarja e presidentit të një vendi mik paraqitej tek unë me propozimin për një marrëveshje. E kisha për detyrë ta dëgjoja e t'i jepja një përgjigje të parë, sa për t'u çelur rrugën bisedimeve të mëtejshme. Ose për t'ua mbyllur, sipas rastit. Nuk dija të kishte ndonjë problem të pazgjidhur midis dy vendeve tona, aq sa të kërkohej shqyrtimi i një marrëveshjeje me urgjencë e në rrethana të tilla kaq informale siç ishte holli i një hoteli në Monako. Më lindi një shpresë e vagullt. Po sikur marrëveshja e saj të kishte të bënte me sherrin e eprorit tim me shkrimtarin finlandez? Në samit kishin qenë edhe drejtuesit e lartë të qeverisë finlandeze. Ishte krejt e mundshme që ata të kishin kërkuar ndërmjetësimin e Presidentit Slloven për ta mbyllur këtë mesele sa pa marrë dhenë zhurma. Shkrimtari në fjalë ishte qytetari finlandez më i njohur e më i çmuar botërisht, i përmendur shpesh e më shpesh vitet e fundit në listat e kandidatëve për çmimin Nobel. Akuza e eprorit tim ndaj tij si racist e albanofob do të hidhte një njollë të keqe jo vetëm mbi shkrimtarin, duke dëmtuar rëndë aspiratën e tij për t'u nobelizuar një ditë të afërme. Njolla do të binte dashje pa dashje mbi krejt kulturën e kombit, që ai mishëronte në veprën e vet. Rrjedhimisht, me të drejtë, udhëheqësit e atij kombi të qytetëruar ishin shqetësuar. Ata po kryenin detyrën e tyre, pra, duke më kujtuar edhe mua detyrën, që më takonte. Ishte në interesin e të dy palëve që ai sherr të mbyllej me aq, të fshihej nga kujtesa e të gjithëve e të bëhej i paqenë kurrë. Dhe eprori im të sigurohej kështu se emri i tij nuk do të gjendej një ditë i damkosur në ndonjë dorëshkrim të shkrimtarit të madh, kur ai edhe nuk do të kishte më mundësi të mbrohej duke i kundravënë të vërtetën e tij dhe brezat e ardhshëm, ata gjykatës të pandikueshëm, do e merrnin të mirëqenë të vërtetën e dhënë nga shkrimtari.

Me ngazëllimin e kësaj shprese brofa në këmbë dhe i zgjata dorën. Ndjeva një diçka si zog të butë të strukej në pëllëmbën

time. Ishim ballë për ballë dhe shumë afër, aq sa unë pata përshtypjen se po shihja në fundin e fundit të syve të saj, ku besova se dallova farfuritjen e një flake si majë gjuhe, që dukej e zhdukej. Do të kisha thënë se brenda saj vlonte një e qeshur, të cilën ajo e përmbante me zor të madh. Nuk do të kisha dashur që ajo t'ia kërciste gazit. Do të prishej gjithë serioziteti i domosdoshëm në bisedimet për një marrëveshje me rëndësi. Unë isha përsëri shumë i tendosur. Por kësaj here isha i tendosur pse nuk po gjeja fjalën e përshtatshme për të përligjur ndryshimin kaq shpejt të mendjes. Sapo i kisha thënë se nuk shihja ç'marrëveshje mund të bënim bashkë. Me një përgjigje të dytë, krejt të kundërt me të parën, pa i lënë kohë as të ngulte një grimë këmbë, do të dukeshat më së paku i paqëndrueshëm, tekanjosh, cilësi këto që e bëjnë një bashkëbisedues paraprakisht të pabesueshëm kur është fjala për të arritur një marrëveshje diplomatike. Unë s'isha i tillë, e njihja veten.

-Në fakt, për ata që më njohin, unë jam njeriu i marrëveshjeve të shpejta. Pse jo edhe një me ju? - Nuk e di as vetë nga më doli një shprehje e tillë, por e kuptova sakaq se ishte shprehja e duhur dhe mora frymë thellë, i kënaqur me veten. Ajo gjëja si zog i butë në pëllëmbën time lëvizti, u bë me shpirt dhe lëshoi një puih të re parfumi bashkë me atë aromën zanafillore të lëkurës së saj, për të cilën nuk po gjeja një emër të saktë, por që mua më shkaktonte një lloj oshtime përbrenda veshëve si për të mbytur të gjitha zhurmërimat e tjera përreth veç atyre zhurmërimave të saj trupore. Sikur isha vënë në një përgjim.

- Shumë mirë, - ma ktheu ajo pa vonesë, me një zë pothuaj të gëzuar. - Unë jam njëra nga ato, që ju njohin me dhëmbë e me dhëmballë. - Dhe tërhoqi dorën nga pëllëmba ime, duke më lënë aty një zbrazëti. Unë çova dorën në xhepin e pantallonave, si të mos e mbaja dot pezull atë gjymtyrë papritur të panevojshme.

Do të kisha dashur ta pyesja, i çuditur, nga më njihnte ajo aq mirë, kur unë atë nuk e njihja fare. Por kafshova gjuhën. Do të kishte qenë njësoj sikur t'i thosha se po fliste broçkulla. Unë isha

i ngulitur tashmë te qëllimi im për të arritur sa më shpejt marrëveshjen dhe nuk mund t'i lejoja vetes asnjë shmangie. Po prisja.

Ajo lëvizi ngadalë njërën këmbë pak përpara, do të thosha si për të fituar një grimë kohë për të kapërcyer ngurrimin dhe më bëri me sy nga kolltuku.

- Ulemi!- tha ajo me atë zërin ku vazhdonte të ndjehej një drithërimë gëzimi.- Kemi shumë gjëra për të folur. - Unë iu binda duke u përpjekur të nxjerr një buzagaz mirëkuptimi dhe zura vendin që kisha pasur. Ajo shkoi përballë.

Paralajmërimi i saj se kishim shumë gjëra për të folur nuk më ngjalli asnjë hamendje të re. Vetëm të fillonim! Nuk kishim kohë për të humbur. Gjinjtë e saj ngriheshin më lart dhe sikur merrnin një rrumbullakësi të re mbështetur mbi dy kupat e gjunjëve të mbledhura drejt për shkak të tryezës, që na ndante. Bëra kujdes të mos e çoj me tepri vështrimin te gjinjët e saj. I vendosur t'i lë asaj radhën për të folur e para, i dhashë vetes lehtë të mendoja për gjëra pa lidhje me çfarë prisja. Ishte si një përpjekje për ta argëtuar pak trurin. Mendova, bie fjala, se këndet e kolltukëve nëpër hollet e hoteleve nuk janë bërë për biseda intime.

- Kemi kohë të flasim, - vazhdoi ajo pasi u sigurua se i kishte mbledhur mirë gjunjët. - Shefi im e do gjithmonë një pushim të mirë pasdreke. Të paktën këtë zakon e ka si ballkanik i vërtetë. Me siguri as shefi juaj nuk bën përjashtim.

- Herë po, herë jo, - thashë unë sa për të thënë diçka.

- Dashtë Zoti t'u japë një gjumë të ëmbël të dyve sot, shefit tim dhe shefit tuaj!

Mua më erdhi të buzëqesh me urimin e saj. Siç isha i ngulitur pas hamendjes time, edhe urimit të saj unë i dhashë nënkuptimin që më përshtatej. Me fjalë të tjera, që eprorët tanë nuk gjenin dot rehati në pritje të marrëveshjes, për të cilën gjendeshim bashkë ne të dy, bashkëpunëtorët e tyre të afërt. Ishte rasti për mua të ndërhyja për të prekur thelbin pa humbur më kohë.

- Le të vijmë te marrëveshja!...

- E drejtë. - Ajo lëvizi pak në ndenjësë si për t'u rehatuar më mirë, mbështolli krahët rreth gjunjëve, m'i nguli sytë dhe vazhdoi: - Dua që këtë pasdite, të paktën sa kohë shefat tanë po

pushojnë, ju të ma kushtoni mua. Nuk është ndonjë marrëveshje e vështirë për t'u miratuar, apo jo? - Ajo kishte vënë buzën në gaz si njeriu i vetëdijshëm se po më kërkonte tepër.

- Më falni, nuk ju kuptova... - Unë vërtet nuk e kuptova.

- A jeni ju Besnik Mustafaj, apo jam unë e gabuar?

- Nuk jeni e gabuar.

- E kam fjalën për shkrimtarin, autorin e *Boshit*?

- Unë e kam shkruar.

- Atëherë, le t'i marrim gjërat shtruar! Unë kërkoj nga ju këtë pasdite. Më saktë, kohën e mbetur deri në zgjimin e shefave tanë nga gjumi i pasdrekes. Nuk po ju kërkoj ndonjë gjë shumë të madhe, apo jo? - Krejt shprehja e fytyrës së saj, bashkë me atë buzëqeshjen e varur në të dy skajet e gojës së saj vazhdonin të nxirrnin në pah vetëdijen e saj të fshehtë se po më kërkonte diçka të sikletshme. Kjo zgjoi, megjithatë, një kureshtje tek unë. Nga i buronte asaj një vetëdije e tillë?

Tashmë i përqendruar në shkrimin e kësaj historie, rrjedhimisht edhe në dijeni të vazhdimin të saj deri në hollësi, nuk kam më dyshim: thellë-thellë ajo ishte krejt e vetëdijshme se po më kërkonte diçka shumë të sikletshme sa për atë vetë aq edhe për mua. Për sa më përkiste mua, më së paku, do të prishte rendin e vendosur vetvetiu gjatë këtyre viteve të fundit në kokën time. Ajo, pra, nuk po më kërkonte t'i kushtoja një a shumë - shumë dy orë të mbetura deri në zgjimin e eprorëve tanë nga gjumi i pasdrekes, kohë gjithsesi e vdekur për mua. Në mos jo me atë femër, ulur rehat në një nga qoshet e hollit të atij hoteli, atë kohë të vdekur do e kaloja në oborrin e hotelit, ku edhe mund të pija duhan, në soditje të gjirit të detit të mbushur me jahte të bardhë dhe një pjesë të Monakos së vjetër aq të lakmuar nga turistët. Nëse i mbahesha mirëfilli fjalës së saj, germës së tekstit siç thuhet në gjuhën e bisedimeve diplomatike, ajo vërtet nuk po më kërkonte ndonjë gjë shumë të madhe. Duke qëndruar me të në një vend, për të cilin e dija mirë se nuk ishte bërë për biseda intime, unë thjesht do i hiqja vetes mundësinë të pija duhan. Kaq do të ishte sakrifica ime. Ndërkohë do të shpërblehesha me atë aromën e saj, që dukej të buronte gjithandej nga lëkura e saj e që do të ishte një shpërblim i pëlqyeshëm siç po e vëreja minutë pas

minute, aq sa arrita t'i them vetes, si të kisha zbuluar një diçka shumë të rëndësishme për mbarë njerëzimin, se një femër me sqimë të vërtetë dallohej edhe te masa në përdorimin e parfumit, për të mos e mbytur atë avullin e padukshëm të trupit të vet, në sajë të të cilit pohohet përreth prania e saj femërore.

Do besuar se ky zbulim mori një rëndësi të tillë të shpërmasur brenda kokës time. Unë isha tërësisht i mprehur për të kryer shërbimin e radhës ndaj eprorit tim, ndërsa ajo femër e panjohur po më shtynte befas e madje përdhunshëm në një drejtim krejt tjetër. Me gjasë ajo kishte parashikuar që unë edhe mund t'i kundërvihesha përpjekjes së saj për të çelur me autorin e *Boshit* një bisedë si kjo që sapo kishte çelur dhe kishte përgatitur një skenar si ta thyente këtë kundërshtim. Përndryshe, unë do e ndiqja në kuturisjen e saj, qoftë edhe i ndihmuar nga ai vaniteti që mbartin më së shpeshti burrat me pushtet të madh në bisedat e rastësishme me femrat e bukura, me të cilat nuk i lidh puna. Do besuar se ajo vetë, në sajë të funksioneve që kryente, kishte pasur me siguri sa e sa herë rastin ta pësonte drejtpërdrejt një vanitet të tillë. Ajo vetë, pra, duhet të jetë zënë kështu në befasi përpara pamjes time prej njeriu që as nuk e kundërshtonte e as nuk e miratonte, por që ishte megjithatë aty, i tëri me të. Ajo ishte aq e përqendruar në qëllimin e vet, sa nuk dukej në gjendje ta merrte me mend me cilën nga shqisat po e perceptoja unë praninë e asaj. Madje ajo nuk dukej në gjendje as të kujtohej se unë mund të kisha ndonjë shqisë tjetër veç atyre, që ajo rrekej të prekte. Dhe ndryshoi zë:

- Ju nuk po mendoni se unë jam e çmendur.

Pikërisht në këtë çast unë pikasa se përtej fjalëve të zgjedhura me kujdes për ta paraqitur si një gjë fare të thjeshtë kërkesën e vet, ajo ishte krejt e vetëdijshme për të kundërtën: që kërkesa e saj ishte fort e sikletshme si për mua, ashtu edhe për atë vetë. Kishte vend që unë të pyesja veten me një farë kureshtje - por jo më shumë se kaq - nga i buronte asaj femre një vetëdije e tillë. Nuk mbaja mend ç'më kishte treguar mbi një lidhje të saj zanafillore me subjektin e romanit tim *Boshi*. Gjithsesi, unë nuk kisha menduar për asnjë çast se ajo ishte e çmendur. Dhe ia thashë me qetësinë e të vërtetës.

- Unë nuk mund të jem e çmendur qoftë edhe për faktin se punoj këshilltare në kabinetin e Presidentit të vendit tim, - vazhdoi ajo. Qetësia ime ja kishte shtuar dyshimin. - Nuk do e linte njeri një të çmendur të këshillonte Kryetarin e Shtetit. Ju kaq gjë e dini më mirë se unë, apo jo?

Unë mund edhe të kisha miratur se vërtet nuk do e lejonte njeri një të çmendur të këshillonte Kryetarin e Shtetit. Madje, një e çmendur nuk kishte gjasë as edhe t'i qasej Kryetarit të Shtetit përpos po të ishte pjesëtare e barkut të familjes së tij. Ajo sigurisht do të kënaqej në sedër për argumentin e betontë, me të cilin ishte mbrojtur ndaj çdo lloj shpifjeje nga ana ime mbi gjendjen e saj mendore. Do të kishte qënë krejt në natyrën time t'ia jepja bujarisht një kënaqësi të tillë të vogël një femre tërheqëse e që mbante erë të mirë, qoftë ajo edhe e paftuar në tryezën time, gjë që do i rriste patjetër besimin në vete. Pata përshtypjen se acarimi i saj i papritur lidhej pikërisht me humbjen e besimit në vete. Në rrethanat kur nuk ishte ndonjëra nga asistentet e shkrimtarit finlandez dhe, si këshilltare e Presidentit të një vendi anëtar i NATO-s dhe i Bashkimit Europian, ajo nuk kishte ardhur drejt meje për të më propozuar një marrëveshje që lidhej me funksionet e saj zyrtare, unë nuk e kisha aspak të qartë përse i nevojitej aq shumë besimi në vete. Unë nuk ia dhashë kënaqësinë e vogël, që po më kërkonte. Vetëm përsërita ç'i kisha thënë një herë, me qetësinë e atij që kumton të vërtetën pa u merakosur nëse besohet apo jo.

- Nuk mendova se jeni çmendur. - Dhe shtova: - Thjesht, nuk ju kuptoj.

Sikur ajo të më pyeste se çfarë nuk po kuptoja, unë nuk do të kisha qenë në gjendje t'i jepja një përgjigje të saktë. Nuk më mbetej gjë e rëndësishme për të kuptuar në këtë mesele tashmë që e dija se ajo nuk ishte qasur tek unë me mendjen të më ndihmonte për t'i hequr njollën eprorit tim, një njollë që mund të fshihej e mund të bëhej e paqenë vetëm aty për aty, brenda asaj pasditeje, sa ishte ende e njomë. Dhe kurrsesi ose me shumë vështirësi më vonë, kur të ishte shndërruar në lëndë për imagjinatën e shkrimtarit finlandez. Ajo njollë përmbante gjithë ç'i nevojitej imagjinatës së një shkrimtari të madh siç ishte shkrimtari në fjalë, për ta katandisur shëmbëlltyrën e eprorit

tim në një gërmadhë të lavdisë, për të cilën ai punonte e me të cilën ai ëndërronte të paraqitej si burrë i madh shteti përpara Historisë së kombit e, mundësisht, më gjerë.

Rrugëtimi i metamorfozës nga personalitet historik në personazh letrar, gjatë të cilit edhe kryhet shndërrimi i të vërtetës objektive, historike në të vërtetën subjektive, artistike, do të zhvillohej ekskluzivisht në imagjinatën e shkrimtarit, një botë tjetër kjo, e mbyllur, ku eprori im nuk mbërrinte dot për ta udhëhequr apo qoftë edhe për ta manipuluar sado pak procesin, pavarësisht pushtetit gati të pakufizuar e pareshtur në rritje, që ai gëzonte midis ne, tokësorëve të gjuhës së vet amtare, në vendin tonë të vogël. Eprori im, me atë instinktin e tij të pashoq, e kishte parandjerë sakaq rrezikun e përfshirjes në një betejë, për të cilën nuk ishte i përgatitur e që rrjedhimisht nuk mund të ishte beteja e tij. Ai u përpoq me aq sa e lejoni rrethanat të më nxirrte mua në vijën e parë të frontit, duke më saktësuar, madje, dhe pa mëdyshje, përse ajo betejë e paparashikuar më takonte pikërisht mua midis ne të dyve: unë isha shkrimtari dhe mbetej posaçërisht në detyrën time t'i tregoja vendin një shkrimtari tjetër, i cili po sulmonte kombin tonë në pikën më të dhimbshme për një komb të vogël - ai po na vinte në lojë mirëfilli inteligjencën tonë kombëtare, po na bënte qesharakë.

Shkrimtari finlandez kishte marrë përsipër të na mishëronte ne, shqiptarëve, në personazhin e arkitektit Gjergj Shkodra, i cili duhej të besonte se po kopjonte projektin e një hoteli luksoz siç mund të jetë një hotel me pesë yje vetëm në Monako, duke vjedhur me një metër metalike përmasat e dhomave, të mesoreve të kateve e të hollit, apo duke pyetur punonjësit e pastrimit të hotelit për trashësinë e mureve mbajtëse. Ai po kryente kështu “spiunazh industrial” për ta zbatuar në vendin e tij. Lexuesit e shkrimtarit në gjuhën e tij e në shumë gjuhët të tjera, ku ai zakonisht përkthehej, do të shkriheshin, me të drejtë, gazi me rrugën e zgjedhur nga shqiptarët, - më në fund zyrtarisht një shoqëri e lirë, - për të fituar kohën e humbur, në zhvillimin

e tyre ekonomik. Ata po e shënonin mëkëmbjen e ekonomisë së tregut të lirë në atdheun e tyre të skamur nga gjysmë shekulli ekonomi bolshevike, me ngritjen pikërisht të simboleve të mbushullimit e të konsumit për rehatinë: hotelet luksoze. Për më keq, edhe ngritjen e këtyre simboleve të mbushullimit e të konsumit për rehatinë, me të cilat shqiptarët duan ta themelojnë futjen e tyre në erën e re, Gjergj Shkodra, si mishërues i shqiptarëve në faqet e romanit të ardhshëm të shkrimtarit finlandez, nuk e përmbush në përputhje me rregullat e ekonomisë së tregut të lirë. Ai duhej të binte në lidhje me arkitektët e hotelit në fjalë, të bënte marrëveshje me ta për projektin. Kjo do të ishte jo vetëm mënyra e ndershme, por edhe më e lehta në një shoqëri të lirë e të hapur për t'ia arritur qëllimit.

Jo. Në pamjen e shkrimtarit finlandez, Gjergj Shkodra paraqitej i brumosur si njeri i bunkerit. Ai kishte qenë arkitekt dhe ndërtues i bunkerëve qysh në rininë e vet e deri në moshën e pjekurisë së burrit, duke humbur pjesën më të bukur e më të gjallë të jetës së vet njerëzore në një përgatitje të ankthshme, rraskapitëse e fort të kushtueshme për t'u mbrojtur nga një armik i tmerrshëm, i cili pritej gjithë kohën, natën e ditën, në dimër e në verë, të vinte nga të gjitha anët njëherësh e po aq nga asgjëkund. Ai kishte qenë po ashtu gjatë gjithë kohës banori i bunkerit të vet, gjë që jep shkas të përfytyrohet përkushtimi i tij i plotë mendor nga fillimi në fund për të kryer një derdhje monolite të përsosur të hekurbetonit, pa i lënë bunkerit as plasaritjen më të vogël, nga ku të përvidhej një rreze dielli a një thërmijë ajri.

Ky përkushtim i gjatë mendor ndaj një kauze abstrakte siç ishte ajo e mbrojtjes nga një armik i padukshëm, doemos që e kishte prekur rëndë trurin e Gjergj Shkodrës, kishte zbehur e rrëguar vatrat më të ndjeshme brenda kafkës së tij. Ishte krejt e kuptueshme që ai të përshtatej me vështirësi të madhe me lirinë. Shkathësia që ai kishte treguar pa vonesë për të pikasur si fitoheshin para shpejt dhe shumë në rrethanat e reja nuk shënonte ndonjë mirëkuptim me thelbin e lirisë. Ishte thjesht zgjimi i një instinkti atavik për të mbijetuar, një instinkt i tulatur si bakter në ndërgjegjen e në karakterin e Gjergj Shkodrës, por